

12.06.2023  
Ora 13.36

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 67 dhe 74.**

**Subjekti ankues: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, Z. Lefter Maliqi.**

**Objekti i ankimimit:**

**1. Ndryshimin e vendimit nr.101, datë 16.06.2023 të KZAZ-së nr. 64, Bashkia Kuçovë, Qarku Berat “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kuçovë”.**

**2. Rinumërim dhe rivlersim i votave për KZAZ-në nr. 64 për të gjitha QV-të**

**PJESËMARRJA:**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmaili,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ-së:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PS: M. Legisi, BF: A. Llangozi, L. Maliqi, O. Serani
- **Të tjerë:** KRIIK

**Z. K. Bele:** Përshëndetje! Riçelim seancën për kërkesën ankimore 67 dhe 74, me ankues Lefter Maliqin, si dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” me objekt ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të KZAZ-së 64 Bashkia Kuçovë, Qarku Berat. Pra, ankimi 67, si dhe ankimi 74, që ka këtë objekt dhe kërkesa të tjera të cilat për

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

efekt kohe s'po i lexojmë, pasi janë të njohura për palët. Prezent është KAS-i me 5 anëtarë, administrata e KQZ-së, sekretari i Përgjithshëm, si dhe për ankuesin konstatojmë prezencën e avokatëve të ankuesit.

**Z. A. Llangozi:** Arben Llangozi –prezent

**Znj. O. Serani:** Orgesa Serani-prezent

**Z. L. Maliqi:** Lefter Maliqi – prezent

**Z. K. Bele:** Gjithashtu është personi i interesuar përfaqësuesi i subjektit politik PS-së.

**Z. M. Legisi:** Avokat Maringlen Legisi

**Z. K. Bele:** Avokati tjetër për koalicionin “Bashkë Fitojmë” është i sëmurë. Dakord. Mirë, atëherë seanca do të vazhdojë. Në fazën e fundit relatojmë që nga ana e palës janë vënë në dispozicion disa prova, kryesisht prova të natyrës së audio-video dhe disa fotografime të cilat na erdhën me flesh, i kemi marrë dhe i kemi parë, si dhe është vendosur që nga pala do të merrej një kopje e kamerave të qendrave të votimit. Nuk e di ku jemi me marrjen e kësaj prove?

**Z. A. Llangozi:** I kemi marrë ditën e premte, na janë vënë në dispozicion nga KQZ-ja, jemi informuar rreth orës 12:00 dhe i kemi marrë rreth orës 2 pamjet të gjitha të qendrave të votimit, përveç 5 qendrave të votimit, ku është konstatuar që

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

nuk kanë funksionuar pamjet filmike, të gjitha të tjerat i kemi marrë. I kemi këqyrur, të cilat edhe sipas kërkesës që ne ju kemi bërë, ju këto pamje filmike i keni bërë pjesë të shqyrtimit tashmë. Njëkohësisht edhe ne me kërkesën tonë kërkojmë të merren në cilësinë e provës. I kemi këqyrur të gjitha pamjet filmike, kemi të bëjmë me dhjetëra e qindra raste, të cilat përbëjnë krim zgjedhor, i kemi të listuara sipas çdo lloj qendre votimi dhe kërkojmë që së bashku këtu t'i këqyrim. Unë i kam marrë me sekuenca të shkurtra, vetëm pjesën ku mendojmë që është, se të këqyrësh të gjithë volumin është shumë. Ne i kemi shkurtuar dhe kemi marrë vetëm atë pjesë të cilën e kemi quajtur të arsyeshme për ta përdorur si provë dhe njëkohësisht që përbën dhe një fakt penal, për të cilën së bashku kërkojmë që të bëjmë kallëzim. I kemi listuar dhe kërkojmë asistencën, ose më saktë, të na lejoni, që ne i kemi shkurtimisht, sepse në qoftë se do të administrohen nga ato materiale që ju keni administruar i bie që të kemi pafundësisht kohë të shpenzuar dëm. Shkurtimisht ne i kemi të përmbledhura dhe kërkojmë që të vëmë laptopin tim në funksion që të këqyren të gjitha materialet.

**Z. K. Bele:** Ylli, më fal, nga ana teknike si mund ta realizojmë parjen e disa videove që ka pala?

**Z. Y. Merkaj:** Siç kemi bërë.

**Z. K. Bele:** Ta çojmë USB atje, nuk kemi mundësi nga laptopi?

**Z. Y. Merkaj:** Mundet.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Dakord. Ndërkaq unë desha, avokat, sa të zgjedhim këtë moment mbase është edhe për radhën e marrjes, duke qenë se ne jemi njohur edhe vetë tashmë me provat, nëse doni të bëjmë debat për provat që ju keni dhënë deri tani, nëse jeni gati pra për këto videot, pra video që ne i kemi parë paraprakisht. Po them që nga këqyrja e tyre konstatoj që ato janë disa topologji, disa video janë të përsëritura mbase njëra është disa sekonda më gjatë apo më shkurt, po kjo ka pak rëndësi. Për shembull, ne kemi një tipologji, po themi, të atyre që kanë të bëjnë me asfaltimet, që mund të ishin 8, 9 video, nuk jam i sigurt, se unë i pashë, por nuk mbajta... Ne ato për qëllimin tonë mund t'i trajtojmë si një video me disa sekuenca dhe ajo që unë dua nga ju, dhe që i vlen këtij shqyrtimi, është lidhja e këtyre me, pra një arsyetim për provueshmërinë. Pra ne shikojmë disa kamionë që derdhin asfalt apo disa rrugë ku janë makineri. Në qoftë se keni një argument që si provohet që këtë e ka bërë kandidati, por më i rëndësishëm se kjo, është fakti si ta lidhim me objektin e këtij shqyrtimi, pra në raport me kërkimet që ju keni bërë. Po ashtu ishin disa video të një feste me muzikë, nuk e di çfarë ishte një aktivitet, ishin goxha video atje. Pra ishin disa tipologji që ju vetë, se po t'i shikojmë me radhë harxhon shumë kohë, për mua janë të njohura dhe për kolegët janë të njohura, se përfituam nga koha, se ishte çështja e fundit dhe i pamë vetë, në ndryshim me herët e tjera që s'kemi pasur mundësi ndoshta fizike, t'i shikojmë të gjitha, flas për vete.

**Z. A. Llangozi:** Po, shkurtimisht, videot në lidhje me asfaltet është e vërtetë që janë disa formate. Këto janë marrë nga denoncime të ndryshme në media, që ne ju kemi vënë në dispozicion edhe material të printuar, që ndodhet aty, ndodhet data, publikimi, denoncimi, denoncuesi është kryetari i Partisë Demokratike për vendin

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

se ku është bërë ky investim. Njëkohësisht në cilësinë e provës ne ju kemi paraqitur që për çdo rast të tillë është bërë dhe kallëzimi përkatës në Prokurorinë e Posaçme, kjo është e provuar sepse kallëzimi është bërë edhe nga ne personalisht, por njëkohësisht dhe nga kandidati në çdo rast hap pas hapi. Në lidhje me atë festë që nga ju është konstatuar kemi të bëjmë me mbylljen e fushatës, ose më saktë, është 2 ditë para mbylljes së fushatës dhe është në orar pune, aty ku ndodhen të gjithë drejtuesit e Bashkisë Kuçovë. Domethënë, në lidhje me këtë fakt ne provojmë që drejtuesit e Bashkisë Kuçovë kanë marrë pjesë në fushatë në orar zyrtar, gjë që sipas nesh e kanë të ndalur edhe sipas Kodit Zgjedhor. Këtë duam të provojmë me atë fakt. Ajo që është më interesantja është se në fotot që unë kam paraqitur, kemi të bëjmë me disa foto ku punonjës bashkie janë duke shpërndarë ndihma, herë me uniformën e Kryqit të Kuq, gjë që kjo ka ndodhur para fushatës, këtu i kemi të gjithë punonjës bashkie pavarësisht se është uniforma e Kryqit të Kuq. Personit i kanë bërë një foto, që është në rreth, është administratori i njësisë administrative Lumas. Të gjithë këta punonjës janë konstatuar edhe me një video tjetër, ku është vënë në dispozicion në cilësinë e provës, aty ku provohet se kemi të bëjmë me punonjës të Bashkisë Kuçovë. Pra, një herë i shpërndajmë këto ndihma si punonjës bashkie dhe herën e dytë i shpërndajmë këto ndihma si punonjës të Kryqit të Kuq. Të gjitha këto janë bërë para fushatës, janë publikuar, janë marrë nëpër media të ndryshme dhe janë administruar nëpër media të ndryshme, të cilat ne jua kemi vënë në dispozicion edhe materialin e shkruar, që është në cilësinë e provës që është e administruar seancën që shkoi. Në qoftë se do t'i shikoni me radhë, se ju ndoshta edhe nuk i njihni, ndërkohë ne i kemi parë dhe i kemi investiguar se kush janë këto persona, që ne mund t'jua themi dhe me emra hap pas

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

hapi në momentin që do të lidhet kompjuteri, se unë 15 minuta kohë do t'ju ha nga e gjithë kjo, në lidhje me këtë material.

**Z. L. Maliqi:** Mund të bëj një ndërhyrje të vogël, relator. I nderuar relator, të nderuar anëtarë të KAS-it, përfaqësues të KQZ-së, meqenëse isha i pranishëm dhe avokatja firmosi te KQZ-ja me përgjegjësi që të mos publikohet asnjë pamje filmike dhe unë kam ruajtur këtë gjë, por dua t'ju them, besoj dhe shpresoj që rasti i Kuçovës të mos jetë rast i përgjithshëm në shkallë vendi, atë që ju kam thënë që në fillim, që në takimin e parë, se kemi të bëjmë me krim shtetëror dhe krim elektoral me ndërhyrje të oligarkut Salillari dhe të ministrit të Brendshëm, të bandave dhe ish-drejtimesve të Policisë së Shtetit. Nuk po ndalem fare te numërimi, procesi, mbyllja e KZAZ –së e të gjitha me radhë, po po ndalem tek ato ç'ka pashë te qendrat e votimit, të paktën shumicën e tyre e kemi parë. Kemi një krim të pastër elektoral ku janë përzier fatkeqësisht edhe komisionerë edhe vëzhgues të opozitës, prandaj kam thënë që paraja bëka punë të madhe, oligarku dhe të tjerë, dhe unë mbaj përgjegjësi për deklaratat e mia, por kemi votime me qindra ne grup, kemi votime nga 2 herë, kemi votime të asaj që është thënë “treni bullgar” në media, që marrin fletën e votimit me vete në xhep në 2-3 vende dhe e nxjerrin jashtë. Pra kemi një sërë shkeljesh të mëdha të papara ndonjëherë, të paktën, në historinë time si politikan që nga 2005-a dhe me këtë unë kam bindjen totale që te fjala që thuhej para zgjedhjeve, që atë bashki ne nuk e lëshojmë, ndryshe ministri le karrigen dhe oligarku përgjigjet para qeverisë. Kështu që me durim, me qetësi, aty çfarë nuk është bërë dhe besoj dhe shpresoj që çdo gjë të provohet. Besoj dhe shpresoj të paanshmëria e juaj, sigurisht edhe një mirënjohje edhe një herë të pakufishme për

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

Kolegjin Zgjedhor i cili dha një vendim duke na i lënë në dispozicion të gjitha provat. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Nuk ka rëndësi, por një sqarim thjesht nuk është se nëse do të vazhdonim, pavarësisht objektit ju nuk do të kishit pengesë që të sillnit të njëjta prova, që të kuptohemi, kjo nuk ka rëndësi se ne jemi në proces dhe e kemi kaluar këtë fazë.

**Z. A. Llangozi:** Kjo gjë edhe nga ana jonë është e mbyllur, nuk ia vlen të diskutohet, ai është mendimi juaj, vendimi juaj që është vendosur ndryshe, kjo s'ka rëndësi, domethënë. Është gjë e mbyllur.

**Z. K. Bele:** Ndërkaq lidhur me këto provat që, pra përmendëm asfaltin elektoral, që ne mund ta shikojmë, pavarësisht se tipologjia është e njohur për ne, ajo që ju quani asfalt elektoral, përmendët aktivitetin politik, ka ndonjë gjë tjetër nga ai grup që doni ta ngrini në vëmendje, apo doni t'i kalojmë shkurtimisht?

**Z. A. Llangozi:** Jo, shpërndarja e ndihmave, por kjo ka të bëjë me stafin, sepse stafi i bashkisë është duke shpërndarë ndihma, domethënë në kohë fushate. Wshtë një me jelek me uniformë bashkie, është i njëjti person me uniformë të Kryqit të Kuq. Domethënë, një herë ka dalë si punonjës bashkie dhe hera e dytë është me uniformën e Kryqit të Kuq. Këto kanë qenë ditë para zgjedhjeve dhe këtë familje, që është ndihmuar, e kemi të provuar sërish që kryetarja, ose me saktë, drejtoresha e bashkisë dhe kryetarja e Partisë Socialiste të asaj zone, e ka shoqëruar në kutinë e

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

votimit pastaj, më pas, që i ka marrë votën. Kështu që edhe kjo është e provuar me video të mëpasme.

**Z. L. Maliqi:** Edhe ata persona që kanë vajtur për të votuar nga kryetarja e Partisë Socialiste asnjëherë nuk kanë votuar në jetën e tyre, me një fjalë, se unë i kam nga zona, janë invalidë, të sëmurë mendorë, janë 2 veta në një familje.

**Z. A. Llangozi:** E njëjta gjë konstatohet edhe nga kamerat e KQZ –së, që ata kanë votuar jo në mënyrë individuale, po kanë votuar në grup. Pra, ajo familje që është ndihmuar ka votuar me persona të tjerë, të cilët e mbështesin në kutinë e votimit. Kjo është e konstatuar me pamje filmike të KQZ-së. Por nuk është se është vetëm kjo, janë me dhjetëra raste me qindra raste të cilët kanë fotografuar votën, çfarë nuk është kryer. Në një qendër votimi është hapur kutia votimit me vota brenda. Në një rast një drejtoreshë e bashkisë, pa firmosur asgjëkundi, ka marrë, ka futur fletë votimi në kuti pa kaluar më parë procedurën e futjes së këtyre votave. Njëkohësisht kemi persona të ndryshëm të cilët kanë votuar nga 2-3 herë, që duken qartë që janë kapur me kamera. Ne kemi shkëputur vetëm sekuenca të vogla, të cilat duken qartë dhe t'i këqyrim. Normalisht në provat që kam sjellë gjatë fushatës, domethënë ne shkurtimisht, se dhe ju i kini parë, në lidhje me provat që ne kemi konstatuar nëpër qendra të ndryshme votimi, unë kërktoj t'i konstatojnë të gjithë. Fillojmë me qendrën e votimit 34-94. Pra këta janë komisionerët, që duken në foto.

**Z. K. Bele:** Po kjo me këmishën rozë çfarë është?

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llongozi:** Vëzhgues. Ja ku kemi votime 3 veta që duken qartë. Këtu 90% e votimeve janë votuar nga 3 veta, votojnë komisionerët, do të duket pak më parë.

**Z. K. Bele:** Aty te kutia janë 3 veta.

**Z. A. Llongozi:** 3 veta, bëhen 5 tani.

**Z. K. Bele:** Ata janë familjarë?

**Z. A. Llongozi:** Atë nuk e di, por edhe familjarë të jenë, Kodi Zgjedhor e ka përcaktuar raste se kur shoqërohet një person që duhet të ketë me patjetër problematika të ndryshme.

**Z. K. Bele:** Avokat, thjesht na sqaroni në lidhje me komisionerët.

**Z. A. Llongozi:** Po ne nuk i njohim se ato janë 15 mijë votime. Personat që ndodheshin në fillim, për shembull, po e kthejmë në fillim. Këtu kemi të bëjmë me komisionerë, janë të gjithë komisionerë, përveç një personi që po shikoni, dhe vëzhgues. Vëzhgues mund të jetë ky me rozë edhe ky personi tjetër që është në këmbë. Të gjithë të tjerët pastaj janë numërues. Ja siç duket, domethënë, që kemi rastin e parë votim në grup. Këtu tani nga 4 veta bëhen 8. Po e shpejtojmë pak, se kemi sa të duash këtu. Ja ku kemi sërish votim në grup 2 persona, se çfarë janë ketë ne nuk e dimë dhe nuk mundet ta përcaktojmë. Videot që kemi marrë nuk janë me orë, nuk e di se si. Ja si dalin nga 2-3 veta. Ja dhe këtu personat, kjo me bluzë jeshile shkojnë bashkë, janë të dy madhorë, ecin me njëri-tjetrin...

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

*(Diskutime pa mikrofon)*

Atë duhet ta vërtetojmë me procesverbalet që duhet të jenë mbajtur, gjë që nuk ka procesverbale të mbajtura. Ajo që është më e çuditshme në një qendër tjetër votimi ka votuar edhe këtu, kemi mbi 10 raste që ky personi, që ndodhet në këtë pikën këtu, ka lënë persona në tavolinë dhe ka votuar vetë në emrin e tyre.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Personi tjetër që është mbështetur te kutitë. Një rast tjetër kemi fshehje të kutive që del një person e fsheh kutitë dhe në një video kemi konstatuar që një zonjë ka futur tre fletë votimi në kuti.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në grup, se nuk mund të themi familjar, votim në grup.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Atë nuk e dimë, mundet. Nuk është se është një qendër, këtu kemi të bëjmë me pafundësi.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Vetë nuk i shikoni dot. Të ecim me 4-5 video që t'i shikoni. Ne kemi edhe relacionin, minutat dhe sekondat se ku ka qenë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kemi rastin tjetër. Ajo qendër, se është 90% e qendrës që ka votuar në formë të tillë. Mirë kjo zonja është e moshuar, po e pranojmë, pavarësisht se duhet të ishte shoqëruar, por shkon edhe grupi tjetër që bashkohet që të marrë vesh se kush ka qenë kandidati që duhet të votohej. Ja ku i kemi, nga 1 u bënë 5 këtu, vota e lirë, ikën të lumtur. Ja edhe kjo zonja që kalon tani, është një zonjë e re, kalon me bashkëshortin, nuk e di se çfarë mund ta ketë, doli. Është një qendër interesante ku

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

mbi 90% që kanë votuar në grup, nga 4 e nga 5. Më e rëndësishme është ky personi, vëzhgues apo komisioner, janë mbi 10 raste që ka votuar ky.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kjo është në fshatin Drizë. Këtu kemi sërish votim 3 veta. Votuan grup prapë, vazhdon kjo punë. Gjithsesi, do të gjej personin ku ka votuar, një rast, se ka 10 raste.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, është vëzhgues, por ka mbi 10 raste.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ky është një moment, por nuk është vetëm një rast, janë 10-15 raste që tregojnë votën. Një rast tjetër në një qendër tjetër votimi është kur hidhen votat, i fotografon një vëzhgues tjetër, i fotografon mbi 4-5 herë. Ja, këtu, sërish grup. Këto janë 90% të rasteve.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Te 400 votues. 450 më duket kanë votuar. A duhen të dokumentohen këto? Atëherë, nuk paska faj koalicioni “Bashkë Fitojmë” që ankohe. Votime në grup sërish. Pra, këto janë pak a shumë. Kush votoi? Votoi personi tjetër që është bashkë me vëzhguesin, dhe votën e hedh vëzhguesi, se ky mund të jetë, por nuk është ndonjë person mund të themi, është me aftësi ndryshe.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Gjithsesi, ne kemi relacionin përmbledhës të këtij materiali. Qendra e votimit nr. 3994. Kemi videon, minuta 11:32, dy prej vëzhguesve shkojnë votojnë së bashku me një votues pa u shoqëruar, kjo vazhdon me kodin që ne kemi bërë. Në minutën 18:30 komisionerja shkon për të votuar në dhomën e votimit pikërisht në momentin... komplet vëzhguesit, që është një tjetër shkelje që kemi konstatuar.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

Qendra e votimit nr. 3494 votim në grup nga ana e votuesve. I kemi të gjitha rastet e videove. Vëzhguesi voton për votuesin e moshuar, e kemi pamjen. Gjithsesi ,një rast ia falim, por kemi me dhjetëra raste të tjera që do t'jua themi. E di kush është më e çuditshmja e këtij rasti? Është votim në grup, vëzhguesi voton për votuesin, i cili stepet dhe shikon të gjithë procesin e kryerjes së votimit të tij, pra voton vëzhguesi, ky e vëzhgon.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Te ky rast, kur voton kryetarja e komisionit, në fund të procesit mblidhen të gjithë që e shikojnë edhe votën se për kë ka votuar.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk është shkelje e rëndë. Dakord. Duken qartë që janë shumë fletë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Janë shumë fletë. Po ja se tani po vihet pajisja në punë. Duket qartë që pajisja tani po vihet në punë. Nëse ne i shikojmë gjitha pamjet filmike, këtu kemi që gjithmonë kalohen votohen pa kaluar te pajisja PEI, atje kemi disa, ai është vëzhgues...

**Z. K. Bele:** Në atë qendër votimi nuk ka punuar pajisja?

**Z. A. Llangozi:** Nuk është raportuar si problem nga ana e komisionerëve. Ky personi që ka votuar këtu është vëzhgues.

**Z. K. Bele:** Kaloi, nuk kuptuam gjë ne.

**Z. L. Braho:** Ky është vëzhgues thoni ju?

*Zbardhi materiplin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Do të duket gjatë gjithë kohës që është aty. Çdo personi i bën foto të votës...

**Z. L. Braho:** Komisioni ku është këtu?

**Z. A. Llangozi:** Nuk duket fare komisioni.

**Z. K. Bele:** Po komisionerët, përfaqësuesit tuaj, kanë lënë ndonjë shënim ndonjë gjë për këto pretendime?

**Z. A. Llangozi:** Po këtu kemi të bëjmë me pavlefshmëri absolute dhe ne i ngremë këto edhe me provë, se kjo është një provë, ky është procesverbali, se kryejnë krime zgjedhore komisionerët, ç'faj ka kandidati në rastin konkret.

**Z. K. Bele:** Nuk thashë që ka faj kandidati.

**Z. A. Llangozi:** Po nuk janë lënë, se janë raportuar që ecuria është shumë në rregull dhe nuk ka asnjë lloj problematike as me pajisjen PEI, ndërkohë që vëzhguesi është duke bërë namin, duket qartë, në të gjitha ...Do ta shikoni deri në fund se sa veprime kriminale ka kryer ai shtetas. I hedh vetë ai. Ndërkohë pajisja nuk është në funksion, kanë votuar pa pajisjet përkatëse. Ja, vajti personi tjetër sërish, d.m.th, atje janë 6 veta...

*(Diskutim pa mikrofon)*

Po, sepse është gjatë gjithë kohës, i kemi edhe emrin atij personi.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Vëzhgues i kujt është?

**Z. A. Llangozi:** I Alibejat, i Partisë Demokratike, gjithsesi nuk është faji i partisë në këto raste. Ne mendojmë që korrupsioni është në nivele shumë të ulëta që të arrihet në këtë nivel është skandal, por nuk është faji që është niveli i lartë politik dhe të ngremë akuza politike. Nuk u ka thënë askush atyre që të bëjnë veprime të tilla. Vazhdon, do të dalë sërish ai, atë punë ka. E njëjti person mori fletët e votimit... kjo zonja ka dalë me fletë votimi nga këtu, do ta shohim momentin kur del. Ka ardhur nga kutia, ka marrë vota të tjera dhe tani shkojnë sërish. Kjo zonja ishte një herë atje. Ky sapo votoi, ishte një herë. Ja votim sërish. Votimi në grup është masiv, nuk është se ka një, dy raste...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Do ta shikosh, dy veta ke këtu. E kontrolluan votën. Do të gjejmë edhe nga ata që nuk hedhin votën e vet, po kështu hidhet vota. Do të gjejmë edhe nga ata që hedhin nga 3 vota, pa problem. Mori 700 vota. Grup sërish. Po e fillojmë nga këtu. Votoi njëri, ja ku e ke, votoi edhe bashkëshortja, 2. Ku di unë çfarë mund ta ketë. Ja sërish. Ja votoi për vete, votoi edhe për të tjerët. Ja edhe grupi tjetër.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Atë nuk e di çfarë mund të jetë. Ka pa fund të tilla raste. Ja, edhe vëzhguesi prapë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ka punë. Vota e lirë. 2 vota.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dakord, prapë vëzhguesi.

E hapi e pa se për kë votoi...

*(Diskutime pa mikrofon)*

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

Ja ku e hapi ta shikoni. 3 veta këtu. Ishte te një kuti, kaloi tek tjetra. Ngeci. 2 veta.

Pse iku?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk ka asnjë votim që të jetë i fshehtë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Komisioner.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Vëzhgues. Ai që hapi fletën. Aty është se do të duket në videot e tjera.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Do të duket në videot në vijim.

*(Diskutime pa mikrofon)*

3 veta. Ky është momenti i fillimit fare.

**Z. K. Bele:** Ylli, çfarë janë këto në fillim?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Z. L. Braho:** Janë kodet e sigurisë.

**Z. K. Bele:** Pra, është procesverbali që hedh në kuti para se të fillojë.

**Z. A. Llangozi:** Dakord.

**Z. L. Braho:** Po videot kështu janë nga 10 minuta?

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Jo i kam prerë unë dhe kam marrë momentet se po t'i shikosh të gjitha... edhe kur i kemi pasur i kemi pasur nga 20-30 minuta ne i kemi shkurtuar.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Qendra votimi të tjera, apo këtu? Se këtu kemi këtë vëzhguesi në disa video duhet ta shohim, fotografon, vete voton. Pra, janë të gjitha momente..

**Z. K. Bele:** JU do të na i bëni prezent si shkelje duke arsyetuar atë që ju mendoni se është shkelje në ndikimin në proces. Sepse ne nuk i bëjmë dot hetim veprimtarisë së atij. Nëse ka vend e bën një organ tjetër.

**Z. A. Llangozi:** Dakord, nuk po flasim që është vetëm ai, por është fenomeni që një person i ngarkuar me një detyrë të posaçme kryen një veprim të tillë dhe është neglizhencë shumë e rëndë kjo që kanë lejuar nga 2 nga 3 persona të votojnë. Këto janë të gjitha vota të pavlefshme. Kjo është ideja. Gjithsesi ne i kemi të listuara shkeljet, por për transparencën tuaj është.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ja duke i bërë foto votës. Zoti Ledio, a mund ta shohësh duke i bërë foto votës? Komsioneri.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ja mund ta shohim kështu me sekuencë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ajo ishte te kutia e kryetarit. Këtu kemi votime masive. Kjo është në Perondi dhe këtu kemi pa fund. Qendra e votimit nr. 3505. Dhe këtu kemi një kuti që kemi konstatuar. Këto kur shkojnë 2 ose 3 veta në një vend tjetër nuk po i quajmë fare, por këtu kemi pa fund votime në...

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, këtu nuk janë konstatuar që këtu vetëm kanë qenë indiferentë i gjithë komisioni, por nuk është se ka pasur parregullsi të tjera.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Jo, 3505, Tapizë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Votime në grup. Vajti kjo zonja.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ja po ta tregoj unë, ajo kutia aty. Vete ky personi para, shkon kjo zonja pas.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Është në masë, në të gjitha qendrat që kemi kontrolluar, vetëm një që mund të ketë 10 votime në grup, në rastet e tjera mbi 100.

**Z. K. Bele:** Të gjitha qendrat i keni kontrolluar?

**Z. A. Llangozi:** Ne na ka mbetur 15 qendra pa i kontrolluar.

**Z. K. Bele:** Pra, shumica.

**Z. A. Llangozi:** Po, shumica. Kjo është masive, kjo ka shumë. Ja këtu kemi serish. T'i japim të gjitha apo nuk është e nevojshme? Gjithsesi ne i kemi te përmbledhja me minuta me sekonda.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Ju i keni në përmbledhësen tuaj, besoj. Ne i pamë, krijuam një ide se për çfarë bëhet fjalë. Më falni a mbaruat, që të marrim dhe qëndrimin e palës lidhur me këtë.

**Z. A. Llangozi:** Po të flasë pala.

**Z. K. Bele:** Avokat, a keni ndonjë qëndrim me çfarë u prezantua nga ankuesi?

**Z. M. Legisi:** Faleminderit! Sa i përket provave të depozituara, do të donim edhe ne të kishim një kopje, në mënyrë që në diskutimoin ëprfundmtar të mbanim edhe ne një qëndrim. Sigurisht që ne i pamë edhe videot. Në vlerësimin tonë na mbetet çështje interpretimi sa i përket pretendimeve në raport me pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe masën sa kanë ndikuar ato. Për sa u paraqit këtu dhe sa pamë theksojmë se jo të gjitha rastet ndikojnë në pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Ky është grupi i videove që ju keni nxjerrë?

**Z. A. Llangozi:** Po, ky është grupi i videove që ne kemi. tani do t'ju tregojmë si votohet 3 herë. A është bërë lidhja e kompjuterit me ekranin?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Më gjej atë që është votuar 2 herë. Videon që ke ti.

**Z. L. Maliqi:** Unë desha të bëj një ndërhyrje të vogël. Komunitat janë gjysma e votuesve, tri ishin njësi administrative, ku të gjitha të dhënat i kishim për një fitore

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

të thellë, pavarësisht se rezultati doli me 400 vota në të tri komunat dhe në një lagje të qytetit. Dhe këtu është bërë ndërhyrja, te qendra e Kozarës është firma nënkontraktore që ka lidhjet edhe me këta të Alibeajt, kandidatit, firma, nënkontraktore e Salillarit, e njëjta gjë pra në Kozare, Perondia dhe Lumasi që pritej një fitore e thellë, janë disa qendra votimi, të cilat janë fshirë fare, nuk i shikojmë, rasti i Krekzës është rasti që edhe aty do ta tregojmë më shembull që kanë votuar mbi 50 veta, me një fjalë që janë njerëzit jashtë dhe nuk ndodh kurrë ai rezultat atje, zona pothuajse e ime. Në të gjitha zonat ku unë kam pasur mbështetje të madhe diferenca ka dalë e vogël, ose diku humbje për shkak të këtyre parregullsive. Pra, aty ka përveç 800 raste që kemi kapur në votime në grup, janë 3 raste që marrin fletën e votimit në xhep, me një fjalë është ajo edhe në Perondi edhe në Kozare, edhe në Lumas. Janë disa lagje të qytetit ku ishte debat i ashpër te 18 kutitë e fundit që dyshohej qendra e kulturës që u mbyll qëllimisht që ishte një çudi e madhe rezultati 100 vota me 34, 99 me 26, ku u kapën dhe kuti pa vula dhe me kode nga një numërues i yni. Kështu që shkeljet janë të hapura, të shumta, dhe unë besoj se ju do të keni mundësinë t'i shikoni të gjitha me vëmendje.

**Z. K. Bele:** Do t'i shikojmë ne. Nëse ka ndonjë gjë teknike që nuk e di dhe unë se çfarë të them.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Është gati? Avokat, sa ju t'i bëni një rregullim të bëjmë 10 minuta pushim dhe ne marrim pak kohë dhe ju i bëni gati ato me qëllim që të ecim shpejt.

*Zbardhi materialin audio  
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Rifillon seanca**

**Ora 14:52**

**Z. K. Bele:** Riçelim seancën, ja një sekondë që të fillojmë regjistrimin. Riçelim seancën me vazhdimin e videove të sjella nga pala ankuese.

**Znj. O. Serani:** Këtu jemi në qendrën 35 13 dhe shihet një djalë i cili merr fletën e votimit, ky që është me bluzë të bardhë, merr fletën e votimit, futet këtu te dhoma për të votuar edhe del pa fletë, e merr fletën me vete.

**Z. M. Legisi:** Si ishte kjo?

**Znj. O. Serani:** Mori fletën e votimit, u fut te dhomë e fshehtë për të votuar, vetëm se nuk po bëhet back.

**Z. K. Bele:** Del dhe tjetri pas atij, e keni momentin apo?

**Znj. O. Serani:** Jo, jo e ka marr fletën e ka futur brenda në bluzë.

**Z. K. Bele:** Jam dakord, por ne nuk shohim gjithë qendrën, pamë vetëm vajti te kutia, duhet të shikojmë të paktën deri në momentin që vete një person tjetër, se ndoshta ai kthehet përsëri.

**Z. A. Llangozi:** Janë kqyrur të gjitha pamjet.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Jo, nuk e paragjykoj unë, nuk e paragjykoj, thjeshtë shikojmë vazhdimin derisa vjen dhe një tjetër që të krijojmë bindjen që ai shtetas nuk kthehet përsëri.

**Znj. O. Serani:** Po në këtë qendër shohim vetëm njërin nga kutitë ku votohet, kurse pjesën e komisionit për shembull dhe gjatë votimit, domethënë ne e ndaluam vetëm te kjo pjesa, por edhe këtu ka votime në grup, është edhe një vajzë, ja ta gjejmë dhe momentin, që fotografon dhe votën, kurse ky djali...

**Z. I. Rusmali:** Tani pa i dhënë përgjigje kësaj, se këtu do dal tani, ne pamë atë zotërinë që hyri me fletë dhe doli pa fletë, por nuk e dimë a ka votuar apo nuk ka votuar.

**Znj. O. Serani:** S'ka votuar fare.

**Z. I. Rusmali:** Po nga ta dimë ne.

**Z. Y. Merkaj:** Fleta ku është fleta?

**Z. I. Rusmali:** Dakord, ne shohim që deri aty shohim që nuk ka fletë.

**Z. L. Maliqi:** E ka futur, po të vësh re shikonte dy tre herë jashtë.

**Z. I. Rusmali:** Se ai shkon me fletë.

**Z. L. Maliqi:** Shkon me fletë dhe shikon dy tre herë këtej nga komisioni.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Znj. O. Serani:** Jo, jo nuk është kthyer, e ka marr me vete se e ka futur nën bluzë.

**Z. K. Bele:** Kemi video të tjera?

**Z. A. Llangozi:** Tek e njëjta video, në minutën e 8:25, kemi fotografim vote, që kanë bërë fotografim të votës.

**Z. K. Bele:** Dakord.

**Z. A. Llangozi:** U rikthye pas video që shkon me votë dhe del pa votë nga kutia. Vazhdojmë me...

**Z. K. Bele:** Që ka nxjerr telefonin, po jo se ka bërë foto.

**Z. A. Llangozi:** Qendra e votimit 34 92 kemi votime në grup, kemi pafund votime, ka shumë video të cilat i kam ndarë me momente, do t'i listojmë që mos të hamë kohën, apo do t'i kqyrim të tëra? Si të doni ju, ne do t'i japim me sekonda, me minuta. Patjetër, patjetër. Votime ne grup ka dhe në këtë qendër, qendra është 35 30-ta, madje madje, kryetarja e komisionit ka vajtur disa herë te votuesit dhe voton bashkë me ta, i kemi të provuara me video të KQZ-së vet.

**Z. K. Bele:** Cfarë qendre ishte kjo?

**Z. A. Llangozi:** 35 30-ta.

**Z. K. Bele:** Fotografimi ishte 35 13-ta?

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Po.

**Z. K. Bele:** Paska të njëjtin fenomen. Interesante këto, e kam më shumë për kandidatin, jo se provon ndonjë gjë, por po shikojmë rezultatin te kjo qendër votimi, kandidati ka fituar 193 me 147, pra kandidati ankues Lefteri ka 193, kurse Hajdari 147.

**Z. L. Maliqi:** Po ta shpjegoj, kurse te këshillat është e përmbysur, por po ta shpjegoj me një fjalë. Nga të gjitha të dhënat nga ato që ju thashë në fillim, fitorja ime në fshat ishte e thellë dhe këtë e dinim të gjithë dhe unë proapë s'jam dakord me këtë rezultat, le të ketë diferencë 20-30 vota në disa qendra votimi, edhe 40 vota, le të kenë, unë nuk jam dakord, sepse e dija vetë me një fjalë se si ishin. Unë kisha mbështetje të majtë si njeri po them nuk po them si forcë politike, unë më shumë fushatën e kam bërë si individ.

**Z. A. Llangozi:** Ne jemi te kjo qendër votimi, meqënëse ka fituar, kjo është qendra e votimit, për kë po diskutohej? Qendra ishte? Po, 35 13-ta, kemi, jo kjo është 30-ta, 35 30-ta, këtu kemi drejtorin juridik të bashkisë, që e quajnë Erjon Plaku, duke shoqëruar njerëz për të votuar, voton dhe vet, ja ky personi është drejtori juridik i bashkisë.

**Z. K. Bele:** Më fal, që mos ta harroj një pyetje se më lindi nga ai diskutimi, nuk dua se, po marr shkas, si provojmë ne që personi që ju mendoni që ka marr fletën e votimit është për subjektin X, pra si e bëjmë lidhjen që ai është për një subjekt dhe jo për një tjetër, nëqoftëse e keni një pretendim të tillë.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Jo, pretendimi është i tillë që ne përderisa kemi kërkuar pavlefshmëri të zgjedhjeve, kjo është në kuadër të pavlefshmërisë, sepse kemi të bëjmë me parregullsi. Të gjitha këto që ne kemi parashtruar janë parregullsi të votimeve në grup. Domethënë kemi mbi 1500 raste të konstatuara që kanë votuar nga 2 nga 3 persona dhe kemi dhe të tilla fenomenesh që janë vepra penale, por vepër penale në rastin konkret është dhe komisioni që i lejon, nuk është se kemi të bëjmë vetëm me ata që fotografohen apo tregojnë votën, është dhe komisioni që nuk merr masa për t'i rregulluar. Nuk është problem vetëm ky rast, unë mendoj që ky rast duhet t'i shërbejë sistemit në tërësi, sepse vijnë kandidatët këtu dhe përballen me ju. Nëqoftëse do merren masa, do parandalohet rasti aktual, nuk do ketë më veprime të tilla dhe do i shërbejë gjithë Shqipërisë, se nuk është vetëm ky rast, këtu veprime të tilla mund të ketë kudo, por nëqoftëse ky rast bëhet shëmbull do t'i shërbejë komplet zgjedhjeve në vijim, demokracisë domethënë. Te kjo qendër votimi kemi pafund raste votime ne grup, të cilat do t'ua listojmë, këtë e morra si shëmbull, që ja drejtori juridik është duke votuar aktualisht në emrin e, ja ku është duke u kapur me votën, në emrin e një qytetareje që s'dihet si e ka marrë. Drejtori juridik është ky, ky është personi e quajnë Erjon Plaku, këtë e njoh personalisht sepse e kemi patur nëpër procese gjyqësore, është ky personi që është duke shoqëruar këtë zonjën. Po, ai është drejtori juridik i bashkisë, nuk e di se çfarë, te ky rast nuk e di çfarë është nuk e kam idenë. S'e dimë atë, atë duhet të dokumentohet, çdo veprim, çdo votim me persona të tjerë duhet të dokumentohet arsyeja pse ka votuar me atë. Dei tani një herë e kam parë, edhe duhet të shikoj edhe qendrën e votimit ku ai ka votuar që nuk e kam parë akoma, se nuk është votues në këtë qendër se nëqoftëse do ishte në këtë qendër atëhere do kishte votuar edhe vet, ai nuk është se ka votuar vetë do të thotë se s'është nëna tij. Ai ka votuar vetëm për zonjën, nuk është se ka votuar për vete në rastin konkret. Dakord por duke qënë se është vend i vogël aty, rrjedhimisht analogjia dhe mundësia më e

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

madhe është që të jenë në të njëjtën qendër. Shumë drejtorë dhe kryetar partish i shoqërojnë vet, si rasti i Lumasit, rasti i Kozait, i shoqërojnë vet njerëzit, i marrin i cojnë për të votuar, drejtues të bashkisë, anëtarë të Partisë Socialiste.

**Z. I. Rusmali:** Shkelja është fshehtësia e votës është cënuar, kjo është shkelja? Votimi i asistuar është i ligjshëm, e parashikon ligji. Por ligji ka procedurë për mënyrën sesi bëhet votimi i asistuar. Këto janë në ligj, tani ne kemi ardhur dhe po denoncojmë një rast të votimit të asistuar, duhet të na thoni çfarë është shkelur nga ligji në këtë rast.

**Z. A. Llangozi:** Po, ligji thotë që jo në çdo rast duhet të votohet në grup.

**Z. I. Rusmali:** Rasti i këtij, drejtori juridik, cila është shkelja ligjore të drejtori juridik, duhet ta identifikoni ju.

**Z. A. Llangozi:** Shkelja ligjore është që ai ka shoqëruar një person i cili nuk është dokumentuar, nuk provohet që personi ka patur problematika, kemi...

**Z. I. Rusmali:** Nuk ka dokumentim të procedurës.

**Z. A. Llangozi:** Po, s'ka.

**Z. I. Rusmali:** Tjetër?

**Z. A. Llangozi:** Po kjo shkelja e Kushtetutës është pavlefshmëri absolute, dhe rrjedhimisht...

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, të lutem, mo sec me vrap se nuk të ndjek dot. Identifikojmë problemin, deri tani kemi identifikuar që nuk ka dokumentim të procedurës për votimin e asistuar, tjetër çfarë shkelje ka?

**Z. A. Llangozi:** Po, a është cënuar fshehtësia e votës?

**Z. I. Rusmali:** Po votimi i asistuar cënon fshehtësinë e votës, e ka brenda konceptit.

**Z. A. Llangozi:** Që të jetë i asistuar duhet të zbatohet procedura.

**Z. I. Rusmali:** Duhet të dokumentohet, kjo është shkelje, këtë thamë, tjetër çfarë ka?

**Z. A. Llangozi:** Është cënuar Kodi Penal, sepse ai ka marrë vesh votën.

**Z. I. Rusmali:** Ore mos na ço te... nuk jemi prokurori ne, ka një denoncim nga ju, thatë drejtori juridik. Fakti që asiston drejtori juridik, është shkelje apo jo?

**Z. A. Llangozi:** Ju e merrni në koncept, drejtori juridik e morra unë si shëmbull, por po marrim një qytetar të thjeshtë.

**Z. I. Rusmali:** Po jo mo, kemi rastin o burrë i dheut, nuk bëjmë hipoteza. Kemi atë burrin që ndihmoi atë gruan për të votuar. Ju thatë që ai, procesi është bërë në kundërshtim me procedurën, se nuk është dokumentuar, nuk i është marrë deklarata që ai të respektojë vullnetin e gruas kur ai të votojë për llogari të gruas, se kështu është e voton ai për llogari të gruas. Kjo s'ka ndoshtur, kjo është shkelje. Tjetër shkelje a ka apo s'ka. Në këtë rast ju, ma thuaj ti mua mos më bëj pyetje.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Ju e parashikoni sikur është dhënë ndihmë, ju e paragjykoni rastin, ndërkohë unë them që kjo zonja ka marr lekët dhe duhet ta provojë, ai punonjës, ai komision duhet të provojë të kundërtën, sepse prandaj është libri i protokollit ku duhet të shënohen këto.

**Z. I. Rusmali:** Kemi provën filmike për këtë na e dhënë, na jepni provën që ka marr lekët.

**Z. A. Llangozi:** Provën që ka marr lekët?

**Z. I. Rusmali:** Po.

**Z. A. Llangozi:** Atëhere është idicie për hetim

**Z. I. Rusmali:** Po pse na thua ne që ka marr lekët, se na e thua që ne të bëjmë një veprim, apo jo? A na e thua që ne të bëjmë një veprim? Na e thua që ne të mbajmë një shënim, dhe na thua kjo gruaja ka marr lekët që ne të themi në vendim, kjo gruaja ka marr lekët ne na duhet prova për këtë.

**Z. A. Llangozi:** Ju në vendim mund të thoni që kjo gruaja, se unë kam marr gjithë librat e protokollit të të gjithë qendrave të votimit nga KQZ-ja, se kjo gruaja

**Z. I. Rusmali:** Kjo gruaja ka votuar në kundërshtim me procedurën për dokumentimin e votimit, po këtë e thamë tre herë, do ta themi prapë?

**Z. A. Llangozi:** Po pra kjo është dhe këtë po e kërkojmë votë të pavlefshme.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Atëhere është kjo, është kjo dhe asgjë tjetër. Është shkelur procedura votimit.

**Z. A. Llangozi:** Shkelja e procedurës në votim është pavlefshmëri absolute, sepse nuk mund të bëhen në të tilla formash.

**Z. K. Bele:** Koncepti është ky, që ne duam të ecim drejt kuantifikimit, pra ju ngrini një, pra kur thoni mund të ketë marr lekët, minimumi është pretendimi juaj, i cili nuk provohet dot, por jemi te fakti që ju thoni kemi një votim të asistuar ose ka votuar në emër të atij, për këtë rast, pra kemi një episod te kjo qendër, sepse kur themi me dhjetra do duhet t'i caktoni minutën, 20, 22, 27(po them kot) që janë pesë apo dhejtë apo njëzetë raste të tilla, nëse ka të tilla. Sepse për të vajtur te ajo që ju thoni do të duhet të kemi gjithmonë parasysh kuantifikimin. Ju e përmendët, e keni thënë gjatë kohës, ne jau sjellim në vëmëndje. Vazhdojmë me videot e tjera dhe ku mundeni kuantifikoheni, sigurisht ku doni të bëni arsyetime të tjera është e drejta juaj, por të mundohemi të jemi brenda objektit dhe të ecim me procesin.

**Z. A. Llangozi:** Edhe këtu, kjo është qendra e votimit 34 23, edhe këtu kemi votime të paasistuara sepse që të jetë votim i asistuar duhet të respektohet procedura. Këtu nuk kemi asnjë lloj procedure të respektuar dhe nuk mundet që një anëtar apo të gjithë anëtarët ta paragjykojnë rastin duke thënë që kemi asistim sepse asistimi në votim duhet të ketë shprehje të vullnetit dhe jepet ndihmë asistim, por jo të votojë dikush tjetër në emrin e një personi sepse në përgjithësi kemi patur raste të cilat futen njerëzit me dy fleta votimi, domethëne kemi patur raste që një person merr katër fleta ikën dhe i voton domethënë në emrin e një personi, kështuqë.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. M. Legisi:** Nuk i kemi parë videot.

**Z. A. Llangozi:** S'ke parë, do t'i tregoj unë.

**Z. K. Bele:** Edhe diçka, një sekondë, ju thatë që keni marr dhe librat e protokollit, dhe duke qënë se i keni parë ato libra ju lutem lidheni rastin, pra nëse për një QV X që ju ngrini këtë pretendim, keni parë dhe në libra të protokollit që nuk ka një shënim për këtë rast, vetëm evidentoheni që të lidhet pretendimi me qendrën, nëse s'mundeni tani për efekt të volumit, do ta bëni te konkluzioni.

**Z. A. Llangozi:** Do ta bëjmë te konkluzionet dhe te të gjitha qendrat nuk ka asnjë dokumentim. Nuk është se është, kjo qendër kemi votime në grup, domethënë janë disa raste nuk është se është një rast. Votime në grup edhe në qendrën 35 28, pamjet filmike kanë qënë 2 orë e 40 minuta, më pas janë shkëputur, nuk është se kanë punuar më. Në 5 qendra votimi të tjera nuk kanë funksionuar fare pamjet filmike. Edhe në qendrën e votimit 35 21 kemi shumë raste votime në grup, në këtë qendrën e votimit me numër 35 16/1, kemi votim më shumë se një herë, më saktë një zonjë ka futur fletë votimi jo aq sa ka marr. Meqënëse donte kolegu, ja do ta tregoj tani.

**Z. M. Legisi:** Çfarë numri ishte qendra e votimit?

**Z. A. Llangozi:** Ky është 35 16/1, po kjo zonja. Ky zotëria që rri këtu në këmbë gjithmonë që bën të tilla veprimesh, i zë pamjen kutive, del edhe pamjen e kameras e zë, por një rast është konstatuar që, domethënë pamjet filmike nuk shikojnë momentin e hedhjes së votës, një rast është kapur, merr dy fleta por fut tre, do ta shikosh vetë, ecim pak para që të konstatohet momenti. Ja tani votin, kjo, po, akoma

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

ska dalë zonja, ky është, po duhet të zë pozicionin e pamjes filmike, ta shikoni në fund. Shikoje tani me vëmëndje, një votë, e hodhi një, e dyta, e treta. Si s'është...

**Z. L. Braho:** Ktheje dhe një herë.

**Z. K. Bele:** Korespondojnë këto fletët e votimit të përdorura?

**Z. A. Llangozi:** Po ku e dimë ne së ajo fleta tjetër është më e vogël dhe mundet të...

**Z. K. Bele:** Zoti Ylli, mund të bëjmë një verifikim te procesverbali për këtë QV, korespondon fletët e votimi të përdorura me ato të gjetura në kuti?

**Z. Y. Merkaj:** Po, çfarë qendre ishte kjo?

**Z. K. Bele:** Për këshillin.

**Z. A. Llangozi:** Për të dyja ta shohim, ta shohim për të dyja.

**Z. K. Bele:** Për këshillin, se është dy vota për këshillin.

**Z. A. Llangozi:** Ku e dimë ne që për kandidatin nuk janë të palosura dy? Fleta për kandidatin është e vogël. Po, sepse ato i bashkon ai, i hedh të bashkuara, është rasti i dytë.

**Z. I. Rusmali:** Nuk tha hodhi dy vota për secilin, tha hodhi dy për këshillin.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Po ngriti dorën dy herë te këshilli, kurse aty njëherë.

**Z. I. Rusmali:** Te këshilli pra, lëvizi dorën dy herë.

**Z. A. Llangozi:** Dy herë, kurse këtu një herë. Ku e verifikojmë ne?

**Z. I. Rusmali:** Ta verifikojmë.

**Z. A. Llangozi:** U fut një fletë Ledio dhe e dyta.

**Z. Y. Merkaj:** Atëhere te tabela e rezultateve, te tabela rezultateve të kësaj qendre votimi janë 171 vota të vlefshme për këshillin, të vlefshme 177 për kandidatin. 5 vota të pavlefshme me 11 vota të pavlefshme. Po t'i mbledhësh është rezultati 282 vota janë në dy kutitë.

**Z. L. Braho:** Sa vota janë përdorur? Sa fletë votimi janë përdorur.

**Z. Y. Merkaj:** Nuk e di, 282 janë vetëm te votat e vlefshme, s'e kemi

**Z. L. Braho:** Fletë të dëmtuara ka?

**Z. Y. Merkaj:** Të dëmtuara jo, vetëm të pavlefshme, jo ska, 0 në të dyja tabelat. Fletë votimi të papërdorura janë 135 me 135, në të dyja rastet.

**Z. A. Llangozi:** 35 09, 35 010-ta, nuk kanë pas funksionuar fare pamjet filmike, 35 22 votime në grup, edhe në qendrën 35 28/1 votime në grup, nuk kanë funksionuar

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

pamjet filmike vetëm 2 orë, edhe në qendrën e votimit 35 24/1 votime në grup. Te kjo qendër votimi kemi të konstatuara shkeljet me minuta.

**Z. K. Bele:** Nëqoftëse është kjo tipologjia avokat, unë them që ne këtë pjesë ta quajmë të ezauruar, nëqoftëse nuk keni ndonjë gjë të veçantë.

**Z. A. Llangozi:** Në Kregës nuk kemi patur fare, është një qendër votimi, si e ka ajo, 34 17-ta që kemi ngritur problemin edhe që nuk ka procesverbal origjinal, edhe që kanë votuar 50 veta që nuk kanë qënë fare në Shqipëri,

**Z. K. Bele:** Çdo të thotë ska procesverbal orgjinal?

**Z. A. Llangozi:** S'ka procesverbale orgjinale në kuti të mbylljes së qendrave të votimit, për të cilën kam bërë dhe aktin e ekspertimit përkatës.

**Z. M. Legisi:** Te kutitë e fletëve të votimit?

**Z. A. Llangozi:** Po te kutitë e fletëve të votimit, pra procesverbali i mbylljes së kutive, nuk egzistojnë, ato nuk egzistojnë në të gjitha kutitë, po te asnjë kuti, ne ngremë dyshimin sepse në disa kemi sjellë një video që dukem qartë që i ka marr dikush, të të tjerat nuk e dimë domethënë, janë nja 15 procesverbale duken që i merr ai në video dhe i tregon se ku janë.

**Z. K. Bele:** Zoti Merkaj kisha një pyetje, porcesverbalet e mbylljes së Qendrës të votimit si rregull janë të secila kuti e fletëve të votimit.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. Y. Merkaj:** Po si rregull po.

**Z. K. Bele:** Është hapur ndonjë kuti materialesh te këto qendra votimi të Kuçovës, nëqoftëse ke dijeni nga KZAZ-ja.

**Z. Y. Merkaj:** Nuk kam dijeni, megjithatë grupi i numërimit nëqoftëse nuk e gjenë procesverbalet te kuti e votimit atëhere hap kutinë e materialeve zgjedhore të gjeje procesverbalin.

**Z. K. Bele:** Pra është kusht që ta gjejnë.

**Z. A. Llangozi:** çfarë rezulton në total, janë gjetur procesverbalët?

**Z. Y. Merkaj:** Pyetje për administratën, për mua?

**Z. A. Llangozi:** Po.

**Z. Y. Merkaj:** Po për sa kohë ne nuk kemi asnjë indicie, asnjë shqetësim, asnjë vërejtje, janë gjetur. Asnjë nga anëtarët e KZAZ-së, as grupi i numërimit nuk kanë ngritur ndonjë shqetësim, ndonjë pretendim që nuk janë gjetur procesverbalet.

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangosi:** Po te kutitë e fletëve të votimit.

**Z. L. Braho:** Pra, procesverbali i mbylljes së kutive.

**Z. A. Llangosi:** I mbylljes së kutive nuk ekzistojnë, ato nuk ekzistojnë te të gjitha kutitë, por...

**Z. L. Braho:** Tek asnjë kuti!

**Z. A. Llangosi:** Tek asnjë kuti, por... ne ngrejmë dyshimin sepse në disa, kemi sjellë një video, duket qartë që i ka marrë dikush, tek të tjerat nuk e dimë, domethënë, janë 15 procesverbale, duken që ka ai në video dhe i tregon ku janë.

**Z. L. Braho:** Zoti Merkaj kisha një pyetje, procesverbalet e mbylljes së qendrës së votimit, si rregull janë tek secila kuti e fletëve të votimit?

**Z. Y. Merkaj:** Si rregull, po!

**Z. L. Braho:** Është hap ndonjë kuti materialesh, tek këto qendrat e votimit të Kuçovës? Nëse ke dijeni nga KZAZ-ja?

**Z. Y. Merkaj:** Nuk kam dijeni. Megjithatë grupi i numërimit nëse nuk e gjen procesverbalin tek kutia e votimit, atëherë hap kutinë e materialeve zgjedhore, dhe gjen procesverbalin e ....

**Z. L. Braho:** Pra është kusht që ta gjejnë.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Janë gjetur?

**Z. Y. Merkaj:** Pyetje për administratën, për mua?

**Z. K. Bele:** Po!

**Z. Y. Merkaj:** Po për sa kohë ne nuk kemi asnjë indicie, asnjë shqetësim asnjë vërejtje, janë gjetur. Asnjë nga anëtarët e KZAZ-së, as grupet e numërimit, nuk kanë ngritur ndonjë shqetësim, ndonjë pretendim që nuk janë gjetur procesverbalet.

**Z. A. Llangosi:** Këshilltarja e koalicionit Bashkë Fitojmë, jo, vëzhguesja e ka ngritur si problem edhe te librat e protokollit, po njëkohësisht edhe te vendimi përfundimtar, nëse i referohemi komisionere, i ka ngritur si problematikë, ndodhet dhe të libri i protokollit, por njëkohësisht ndodhet dhe te vendimi 101 që kemi të bëjmë... është konstatuar e njejta problematikë. Por problematika ka qenë më e madhe, sepse nuk ka qenë kaq, aty janë zhdukur të gjithë procesverbalet origjinale, dhe ne ua kemi sjellë më video, keni një video që është bërë një denoncim, të cilin e kemi sjellë seancën që shkoi. Nëse doni, do ta dëgjojmë.

**Z. L. Braho:** Tani edhe njëherë...

**Z. A. Llangozi:** Nuk janë gjetur procesverbalet origjinale. S'e kam këtu. E kemi depozituar si provë, por ne e kemi lexuar.

**Z. L. Maliqi:** Po edhe një numëruese e ka konstatuar dhe mungesën e procesverbaleve, edhe një numëruese...

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Ne i kemi kopjet, po s'i kemi këtu sot se ishim përgatitur për tjetër gjë, gjithsesi ne i kemi depozituar edhe pranë jush, si provë.

**Z. K. Bele:** I janë ndërruar vulat, pra vulat e kutisë së kryetarit janë te kutia e këshillit dhe anasjelltas. Le të bëjmë verifikimet përkatëse.

**Z. Y. Merkaç:** Në librin e protokollit 5, vetëm një rast është që nuk është gjetur procesverbali, grupi i numërimit ka hapur kutinë e materialeve zgjedhore, ka gjetur procesverbalin, ka vazhduar votimin.

**Z. K. Bele:** Kemi evidentuar dy raste deri tani që nuk janë gjetur, dhe është vendosur të hapet kutia e materialeve.

**Z. A. Llangozi:** Edhe në një rast thuhet që nuk u gjet, dhe sërish u rinumëruan dhe u mbyll kutia.

**Z. K. Bele:** Do ta shikojmë. Pra libri është ky, dhe këtu, nga kjo që ju keni sjellë nga libri i protokollit, nëse unë dhe besoj jam i saktë, se ishin dy raste që evidencohesh mosgjetja e procesverbalit dhe KZAZ-ja, ka vendosur ta hapë kutinë e materialeve. “Nuk ka shënime të mëtejshme në mbylljen e tabelave, kemi arsye të besojmë që është gjetur ai procesverbal në kutinë e materialeve”. Pra, kaq na rezulton nga kjo provë.

**Z. A. Llangozi:** Ne ju kemi sjellë provë tjetër, e cila është, dhe duket qartë që procesverbalet origjinale janë rreth 15 copë, nuk ndodhen në kuti. Është një video, të cilën ne e kemi paraqitur në cilësinë e provës, është një denoncues, i cili

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

pretendon se procesverbalet origjinalë janë zhdukur me urdhër, dhe ajo i ka nxjerrë aty i ka filmuar që duken procesverbalet origjinalë që i kanë mbi tavolinë.

**Z. K. Bele:** Avokat, jam dakord do shkojmë atje. Po për ta ezauruar, për librin e protokollit që keni prurë ju, këtu thotë: në faqen..., po i datës gjashtëmbëdhjetë i pesti. Besoj këto shënime kemi, nuk kemi shënime të tjera. Këto të dyja që thashë unë.

**Z. Y. Merkaç:** Është një vetëm është vetëm qendra e votimit 3516.

**Z. K. Bele:** Gjithsesi, ne e kemi këtu para, s'besoj se keni gjë për të shtuar, nga kaq ne na rezulton dhe nga libri i protokollit, pastaj vazhdojmë tek ajo videoja tjetër që keni për të diskutuar.

**Z. A. Llangozi:** Dakord, kalojmë te video?

**Z. K. Bele:** Atëherë në këtë fazë mbyllëm videot e qendrave të votimit.

**Z. A. Llangozi:** Videot e qendrave të votimit, gati 1500 raste, janë që kanë votuar në grup, pa dokumentuara, me procesverbalet përkatëse, arsyen pse një person shoqërohet në kutitë e votimit. Kështu që për ne janë vota të pavlefshme, të cilat do t'i bëjmë dhe në arsyetim, me minuta, me sekonda, se ku ndodhet kjo video përkatëse, se aktualisht ne bëjmë një këqyrje shumë të shkurtër, por do t'i referohem në konkluzionet tona. Kalojmë te video...

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Më fal për palët e interesuara, ka ndonjë prapësim për të bërë në këtë moment?

**Z. M. Legisi:** Jo! Siç e thashë edhe me përpara, ne do ta vlerësojmë këtë moment për konkluzionet përfundimtare dhe do të japim edhe pretendimet tona.

**Z. K. Bele:** Po vazhdojmë me... këto janë materialet që na keni dhënë me flesh.

**Z. A. Llangozi:** Po këto janë materialet që ju kemi dhënë me flesh. Ti fillojmë me radhë, se shkurtimisht do t'i kapim. Zotëria që ndodhet me rreth të kuq.

**Z. I. Rusmali:** Intervista, duhet intervista

**Z. A. Llangozi:** Ah, duhet intervista, dakord. Kjo është video. Nuk e di. Këto janë procesverbalet origjinalë. Janë disa kuti votimi. Ta kthejmë edhe njëherë nga e para?

**Z. I. Rusmali:** E ngrejmë dot zërin?

**Z. A. Llangozi:** S'e di ku e ka zërin. Duhet të jetë atje zëri, sepse këtu është në maksimum.

**Z. I. Rusmali:** S'ka gjë se ne e kemi parë, vetëm përcillenë se ç'është ai njeri në intervistë. Apo nuk doni ta bëni?

**Z. A. Llangozi:** Po ne e kemi sjellë si provë kështu që normal...

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Komentoje!

**Z. A. Llangozi:** Po, në këtë video është një person, i cili shfaqet si numërues, dhe pretendon se me urdhër janë hequr të gjithë procesverbalet nga kutitë, procesverbalet origjinalë, të mbylljes së kutive nga kutitë përkatëse dhe në pjesë të ndryshme të videos, shfaqen procesverbalet me datë, me numër dhe me numrat kutish, të cilat vërtetohet se janë origjinalë, duket që janë origjinalë, dhe vërtetohet se janë disa, jo se është një procesverbal, janë disa procesverbale.

**Z. L. Braho:** Dakord, sa kuti?

**Z. A. Llangozi:** Janë rreth 15, po nuk identifikohen.

**Z. I. Rusmali:** Për ju është e qartë, e marrim për një moment të saktë atë që thotë personi, i cili është i paidentifikuar. Për ju është e qartë, se kur janë hequr procesverbalet nga kutitë, sipas rrëfimit të tij?

**Z. L. Maliqi:** Jo, unë dyshoj tek ai vendimi i famshëm i braktisjes së KZAZ-së, pa vendim KQZ-je, ku dhe ai drejtori që shikoni aty ka dhënë ndihma, ka qenë i kulturës (atë punë bën në çdo zgjedhje), edhe nga kamerat e sigurisë, kutitë e votimit, gati 18, rreshtin e tretë, nuk e kap fare kamera e sigurisë, nuk e kap komplet një pjesë për disa minuta edhe unë ju thashë që Qendra e Kulturës, me kutitë e votimit është dera ngjitur dhe Qendra e Kulturës është e lidhur me një oborr, fushë, pastaj shkon në shkollë, rrethohet me një mur në errësirë totale. Gjë që unë e kisha veënë në dijeni edhe OSBE/ODHIR-in, por edhe komisionerin,

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

KZAZ-në që nuk duhet të ikni nga KZAZ-ja. Ata ikën në njëmbëdhjete e njëzet (11:20), unë kisha debatin siç ju thashë dhe kanë ardhur në një pa njëzet (13:40). Këtu bëhet e gjithë, prandaj qe dhe ajo përplasja, tensioni, ku deri në 40 kuti, unë isha rreth 400 vota para, te 18 kutitë e fundit, pavarësisht, tek këto 40 kishte tension, përplasje midis numëruesve, 2 numërues nuk i kishin mbi tavolina, ajo e pesta se këtu është dhe një gjë e mirë, se po na ikin jashtë shtetit ca numërues edhe komisioner, po na ikën tani pas kallëzimeve në SPAK, kështu që te këto 18 kutitë e fundit, me një fjalë, dyshojmë ne, që këto procesverbale...

**Z. I. Rusmali:** Pra heqja e procesverbaleve nga kutia ka ndodhur përpara se të bëhej numërimi?

**Z. L. Maliqi:** Mbase, por më përpara, se në numërim aty e shikonim ne, e shikonim.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Zoti Merkaj, nëqoftëse ikin procesverbalet, hiqen në një mënyrë ose një tjetër, hiqen nga kutia e fletëve të votimit, ca ndodh me kutinë. Si hapet kutia kur numërohet?

**Z. Y. Merkaj:** E para që të hiqen nga kutia e fletëve të votimit duhet të hapet kutia, do të prishen ato kode dhe do të vuloset me të njëjtat kode, me të njëjtat numra...

**Z. I. Rusmali:** Dhe nuk ndodh kjo? Mund të vuloset!

**Z. Y. Merkaj:** Jo, nuk ndodh. Nuk ka. Kodi është unik, është i njëjtë, e para, e dyta, procesverbalet shpërndahen aq kopje sa ka anëtarë komisioni i qendrës së votimit.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

Të gjithë anëtarët e komisionit të qendrës së votimit i kanë nga një kopje të procesverbalit...

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë përveç asaj që është brenda në kuti ka edhe jashtë të tjera, po ato janë kopje nuk janë origjinale.

**Z. Y. Merkaj:** Ka dhe 7 të tjera. Si rregull origjinali.... po ajo është kopje është me letër që lë shenjë, vetem kopje parë shënohet...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem avokat mund të na e nxjerrësh atje në pamje, të lutem avokat në pamje te video është një pamje e procesverbaleve.

**Z. Y. Merkaj:** Mund ta shpjegoj atë pjesën

**Z. I. Rusmali:** Jo prit të dalin ato dhe të na thuash, janë kopje apo janë origjinale!

**Z. K. Bele:** Aty duken vetëm 4 fleta. Unë se kuptoj këtë, është minura njëzet e tre që e kam ndaluar...

**Z. I. Rusmali:** Materiali i tretë, është intervista, jo i katërt...

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë procesverbali është në kopje, me flete me kopiatv quhet, vetem të kopja e parë është origjinali. Të gjithë kopjet e tjera lënë gjurmë dhe janë numrat e kodeve këto kopje u shpërndahen anëtarëve të qendrës së votimit.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Të bëj një pyetje. E konsiderojmë në këtë rast procesverbali është brenda.

**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. I. Rusmali:** Hapet kutia, nxirret procesverbali origjinal, numërohen votat, më saktë, bën Grupi i Numërimit procesverbalin, tabelën etj etj, mbyllet kutia. Me këtë procesverbalin e KQV-së, çfarë ndodh, ku shkon ky? Hidhet brenda prapë? Çfarë ndodh?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, jo, ky i dorëzohet KZAZ-së.

**Z. I. Rusmali:** I dorëzohet KZAZ-së. Dakord, tani, pyetja që kam unë është juridikisht çfarë vlere ka ky për procesin, nëqoftëse i dorëzohet KZAZ-së, ikën lidhja me kutinë, se ikën nga kutia, kutia është vulosur me vula të reja. Për vulat e reja ka procesverbal.

**Z. Y. Merkaj:** Po! Është tabela e rezultatit, është tabela e rezultatit.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Vetëm me ndiq te logjika. Çfarë vlere juridike ka ky i pari që doli nga kutia, më për procesin?

**Z. Y. Merkaj:** Nuk ka më vlerë ai thjesht grupi i numërimit bën kontrollin e mbylljes së qendrës së votimit me hapjen dhe kontrollon: Kjo kuti votimi është mbyllur me këto kode sigurie apo jo. Në momentin që të katërt anëtarët e grupit të numërimit bien dakord ose 3, s'di sa janë...

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Në momentin kur po hap kutinë?

**Z. Y. Merkaj:** Po, kur hap kutinë.

**Z. I. Rusmali:** Dhe pastaj në momentin e parë. Dakord!

**Z. L. Braho:** Tani të ndjekim pak avokatin ose kandidatin. Këtu po bëhet, domethënë pretendimi juaj qëndron në faktin që këto procesverbale janë nxjerrë përpara se të numërohen këto kuti. Pra në atë fashën orare pasi janë dorëzuar të gjitha materialet në KZAZ, dhe sipas jush mund të jenë disa kuti votimi që janë hapur në fshehtësi. Është nxjerrë procesverbali origjinal – ky është pretendimi juaj, - janë mbyllur prapë kutitë me kodet e reja, dhe është futur procesverbal i ri, dhe kur GNV-ja ka hapur për të numëruar fletët e votimit ka pasur një procesverbal aty brenda. Ky është pretendimi juaj?!

**Z. L. Maliqi:** Këto janë dyshimet e mia.

**Z. L. Braho:** Po dyshimet!

**Z. L. Maliqi:** Për shkak të asaj që ndodhi në njëmbëdhjete e njëzet (ora: 11:20) deri në një pa njëzet (ora: 13:40)

**Z. K. Bele:** Nëqoftëse e kuptojmë drejt ndryshimi i procesverbalit nuk bëhet për lojë shpejtësie, për të ndërruar procesverbalin, duhet të ndryshohet kutia, të ndryshohet numri i votave që të krijohet një disavantazh të padrejtë, ose të prishësh kutinë fare.

*Zbardhi materialin audio*

*Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Maliqi:** Sepse mund të jenë bërë edhe procesverbale edhe më përpara ai që ka bërë atë krimin elektoral, që dyshojmë ne, heq atë fletën, vë fletën, vë procesverbalet në vendet e tjera, ku di unë. Por derisa këto procesverbale janë origjinale që i ka treguar...

**Z. A. Llangozi:** Qëllimi është pse do t'i zhdukjin, ose pse nuk do të ishin në kuti? Se ky është material zgjedhor që ka një qëllim të caktuar.

**Z. K. Bele:** Ne nuk e dimë nëse janë apo s'janë në kuti. Ngrihet një pretendim, dhe personi që do ta dëgjojmë që flet në këtë materialet që keni sjellë ju thotë: "na urdhëruan t'i ndërronim më pas". Le ta dëgjojmë!

**Z. L. Braho:** Sa qendra votimi me numër të saktë verifikoni ju nga kjo video? Pra ju thoni janë 15, po një, dy, tre, qendra votimi nuk e identifikoni me numër?

**Z. A. Llangozi:** Ne kështu e mendojmë, por nuk duken numrat, vetëm një duket, i pari, pastaj janë fletë.


**Z. L. Braho:** Po i pari sa e ka numrin?

**Z. A. Llangozi:** Ta shohim aty se nuk e mbaj mend.

**Z. I. Rusmali:** Zë për këto që po thoni ne nuk kemi, tani dërgojeni te këto... të shohim! Ndaloje! Ku është kjo qendra e votimit?

Personi që flet në video: "...nga kryetari i bashkisë dhe na është njoftuar nga kryetari i KZAZ-së, Erald Shushari, gjithashtu dhe nga sekretari, Romeo Musai, - ne e kemi bërë këtë gjë, i kemi hequr procesverbalet origjinale nga kutitë, dhe që

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

nga ajo natë, deri më sot, e kam vuajtur këtë gjë, dhe kam qënë gjatë gjithë kohës me frikën se mos e vërteta do të dali në shesh, edhe do të përballesha për këtë gjë që ne e kemi bërë. Nga e gjitha kjo e vetmja gjë që jam bërë pishman është që procesverbalet që më urdhëruan që t'i hiqja unë i kam mbajtur dhe i kam sjellë këtu që t'ua kallëzoj..."

**Z. I. Rusmali:** Sa ka kjo KZAZ-ja 64, sa qendra votimi ka? A i përputhen numrat? Është rastësi kjo, apo ka qenë me qëllim? Mund të hapen tabelat e QV-ve 64, dhe të shihen ato 4 kodet ekzistojnë gjëkund apo jo?

**Z. Y. Merkaj:** Po, na duhet kohë po ta shikojmë. Po ky personi kush është, apo s'dihet?


**Z. I. Rusmali:** E dini ju kush është personi? Ju e keni nga burimet publike apo jo?

**Z. A. Llangozi:** Po ta kishim ditur do ta kishim sjellë këtu padiskutim, patjetër.

**Z. K. Bele:** Ja u lexoj unë 4 procesverbalet, 3 kodet e para: 151660, 151657, 151659, - janë tre kodet e para; i katërti nuk duket; 1516 është dhe i katërti, po s'dalin dy numrat e fundit; 151660, 151657, 151659 edhe 1516 dy numrat e fundit nuk i shof; edhe numri i pestë është 50, por nuk shoh këtë të gjashtin; ë 57, i fundit, vula e katërt është 151657, 51 me fal, duket 51.

**Z. I. Rusmali:** Prit, është një kuti tjetër e të njëjtës qendër votimi. S'e di mund të jetë te materialet... Është një kuti tjetër që thotë 171865, 171867, 171866, i katërti nuk dallohet.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Maliqi:** Edhe te qendra 3534/1, në mesditë janë prishur vulat, dhe është në video, është evidentuar këtu, te libri i protokollit dhe kanë dërguar vulat e tjera një i KZAZ-së.

**Z. A. Llangozi:** Tani ne do kemi kopjet, apo origjinalet, procesverbalet origjinale?

**Z. K. Bele:** Këto procesverbalet; palët marrin nga një kopje dhe ato janë po me një pamje, pra janë të... s'kanë ngjyra? Kjo që shohim këtu, kjo me ngjyra është origjinale. Kam dhe një pyetje tjetër avokat ne shohim një fragment video, sigurisht ju ndoshta s'e dini nga origjina e saj, dhe ne shohim kurrizin e një personi derisa flet, por nuk kemi vizualizim të faktit nëse ka folur ai person në atë moment, apo ka një moment që flet dikush tjetër po aty, apo më mbrapa.

**Z. A. Llangozi:** Fakti është se dhe atë dhe ne nuk e përcaktojmë dot se cili person është. Por ajo që është e vërtetë në atë video është se, aty janë disa procesverbale origjinale, nuk mund të hamendësojmë tani që ne e kemi si dyshim dhe në një rast që është konstatuar dhe nga librat që është aty, kemi dyshim që këto procesverbale nuk ekzistojnë në kutitë e votimit, se në dijeninë tonë duhet të jenë në kutinë e votimit, se është material zgjedhor që duhet të rrijë brenda në kutinë e votimit aktualisht. Kështu që ne ngremë dyshimin që nuk janë, kështu që për këtë...

**Z. K. Bele:** Që të vazhdojmë me diskutimet tona...

**Z. I. Rusmali:** Zoti Merkaj, nga pamja që ne na del këtu, nga kjo intervistë, na del në plan të parë një procesverbal për vulosjen e kutive të votimit, përpara fillimit të

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

votimit, dhe del në plan të dytë një procesverbal për mbylljen, po kaq lexohet. Çfarë është ky procesverbal për mbylljen, çfarë është? Ka një kuti të zezë ku thuhet KQV numër... , KZAZ numër... , bashkia ... dhe ato plotësohen. Çfarë është ky procesverbal për mbylljen. Për mbylljen e qendrës së votimit. Ky tip. Ky nuk ka kode, apo ka kode? Po me këtë procesverbal çfarë ndodh? Dakord, kur hapet kutia dhe numërohen votat çfarë ndodh këtu?

**Z. Y. Merkaj:** Evidentoj nga grupi i numërimit, pasi rakordojnë me numrat që janë kodet dhe numrat shënohen në procesverbal, vazhdon me hapjen e kutisë, dhe ky procesverbal i jepet KZAZ-së.

**Z. I. Rusmali:** Tani KZAZ-ja me gjithë këto materiale zgjedhore çfarë bën?

**Z. Y. Merkaj:** I dorëzon në protokollin e KQZ-së. Prandaj mendojmë që duhet të jetë këtu, duhet të jenë këtu.

**Z. I. Rusmali:** Po ju e verifikoni dot thjeshtë këtë KZAZ-në 64, apo jo?

**Z. Y. Merkaj:** Po pra

**Z. I. Rusmali:** Duken të gjitha 64, aq sa shofin ne, nuk është se shofin shumë. Mund ta verifikoni dhe këtë!

**Z. Y. Merkaj:** Patjetër.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Sa të shkojmë të provojmë të gjejmë nga ky informacion që ju na dhatë, e ezaurojme diskutimin në lidhje me tipologjinë e videove të tjera që keni aty, sepse ne ato i kemi parë në ndryshim nga këto që nga thatë janë të njëjtat thjesht nëse keni ju ndonjë gjë që doni ta evidentoni, përndryshe, ato janë pjesë e provave dhe mund t'i trajtoni në...

**Z. A. Llangozi:** Nëqoftëse ju i keni vlerësuar dhe kanë cilësinë e provës atëherë t'i futemi diskutimit përfundimtar.

**Z. K. Bele:** Po, prandaj ne u ndalëm këtu

**Z. A. Llangozi:** Dakord!

**Z. K. Bele:** Prandaj ne u ndalem te kjo që e lidhim me provat tuaja.

**Z. A. Llangozi:** Tani ne do t'i kërkojmë që të gjenden këto procesverbalet origjinale, më pas do i kërkojmë konkluzione, kohë për konkluzione.

**Z. K. Bele:** Bëjmë 15-20 minutësh pushim. Është e arsyeshme? Dhe mblidhemi përsëri...

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.06.2023*

**Rifillon seanca**

**Ora 19:00**

**Z. K. Bele:** Mirëmbërëma! Riçelim seancën. Relatoj që seanca është ndërprerë pasi është kërkuar prezenca e përfaqësuesve të KZAZ-së 64, kuçovë si dhe një dokumentacion shoqërues, i cili është kërkuar në këtë shqyrtim në lidhje me pretendimin për disa procesverbale të sjella nga ankuesi nëpërmjet një video, e cila u pa nga ana jonë. Zotëria që ka ardhur prezantohuni ju lutem!

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Erald Shushari, kryetar i KZAZ-së nr. 64.

**Z. K. Bele:** Dakord! Konkretisht ne kemi kërkuar procesverbalet origjinale... Çfarë dokumentacioni keni sjellë?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Atëherë, kam dosjen që mban KZAZ-ja, që i dorëzon grupit të numërimit. Ndër të tjera këtu janë dhe kodet e procesverbalit të mbylljes së votimit nëse nuk gaboju është KQV 00008.

**Z. K. Bele:** Po kërkojmë një kuti specifike për nevojat e hetimit tonë dhe nuk e di si do e gjejmë. Na e sillni dosjen. Në foton që ne kemi parë është ky procesverbal 07. Do të na e sillni të gjitha. Në video ishte një me kodet 1516.. ta gjejmë.

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Nuk janë të gjitha, janë ato që nuk janë futur në kutitë e votimit.

**Z. K. Bele:** Dakord! Ndoshta është ndonjë nga ato.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi, avokat :** Ju lutem mund ta di se ku e ka gjetur bazën ligjore kryetari i KZAZ-së të mbajë këto materiale zgjedhore?

**Z. K. Bele:** Pyetja nga pala është pse këto materiale zgjedhore në dijeninë tuaj...

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Atëherë, në zbatim të neneve ligjore por edhe udhëzimeve të KQZ-së ne e kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin sipas këtij udhëzimi në KQZ dhe me gjithë materialet zgjedhore në Lundër. Pra, gjithë pjesën tjetër që kemi patur detyrim ligjor për ta dorëzuar, e kemi dorëzuar.

**Z. A. Llangozi, avokat :** Tani nuk e ka detyrim ligjor, nuk po e kuptoj unë këtë. Në çfarë neni është që nuk e ka detyrim ligjor dhe ka detyrim ligjor të mbajë materiale zgjedhore.

**Z. K. Bele:** Nëse e kuptova unë drejt. Eraldi tha: -Ne e kemi dorëzuar çfarë kemi detyrim ligjor për të dorëzuar, pjesën tjetër e kemi mbajtur në KQV. Pra kemi zbatuar detyrimin ligjor për ato që na janë kërkuar ti dorëzojmë. Deri këtu mua më duket korrekte, gjithsesi...

**Z. A. Llangozi, avokat:** Nuk është korrekte sepse ku e ka dokumentin se çfarë i është kërkuar. Nuk është korrekte.

**Z. I. Rusmali:** Ne i kemi bërë pyetje kryetarit të KZAZ-së. A mund të na gjejë ai në dosjen që disponon një procesverbal që ne e kemi kërkuar me kode specifike. Kjo është pyetja. Ai duhet të kërkojë se çfarë ka gjendje atje nëse na e gjen dot apo jo.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

Mbarojmë këtë gjë njëherë pastaj vazhdojmë më tutje. Të na japë përgjigje e gjen apo nuk e gjen, e ka apo nuk e ka, pastaj vazhdojmë me analizat, me komentet, me objeksionet, me të gjitha.

**Z. K. Bele:** 1159 dhe 151651, kjo është në foto 171865, këto janë kodet, 171867 dhe 171866. Ky është procesverbali origjinal.

**Z. Y. Merkaç:** Kjo është kopja që kanë marrë anëtarët e QV-së.

**Z. I. Rusmali:** Kryetar tani do të na shpjegoni përse ky origjinal ndodhet në këtë dosje dhe përse nuk ndodhet në kutinë e fletëve të votimit?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Atëherë, si është problematika... Prej vitit 2013 une kam qenë gjithmonë anëtar në KZAZ dhe ndodh që kopjet i kalon në kutitë e votimit dhe mban origjinalen vet dhe i dorëzon dorazi. Janë gabime procedurale por...

**Z. I. Rusmali:** Ky procesverbal specifik, nuk më duhen 20 apo 30 të tjerat. Si ra në dorën tuaj?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Na është dorëzuar ditën kur u dorëzuan materialet zgjedhore.

**Z. I. Rusmali:** Ju dorëzua me dosje?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Po, me dosje. Dosja që ne i japim një kopje kur i marrim materialet, na e kthejnë mbrapsh një pjesë.

**Z. E. Lako:** Po kopja e karbonit ka qenë brenda në kuti?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Po ka qenë brenda në kutinë e votimit.

**Z. E. Lako:** Kopjen e këtij procesverbali? Kanë lënë kopjen dhe origjinalen...

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Origjinalen e kanë marrë...

**Z. E. Lako:** Te të gjitha këto ka origjinale?

**Z. I. Rusmali:** Të lutem pyetjen që ne bëmë e ezauroam. Tani nëse ju keni pyetje ju jeni të lirë të bëni pyetje, por e para do ju lutesha për këtë, pastaj për të tjera, më kupton? Të sqarojmë këtë tërësisht, pra vetëm këtë kuti, Pastaj për të tjerat padiskutim jeni të lirë të bëni pyetje të tjera. Fillimisht përqëndrohuni te kjo, nëse jeni dakod.

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për kryetarin e KZAZ-së. Tani ju normalisht jeni njohës i legjislacionit zgjedhor, njohës i manualit, udhëzuesit të punës së KZAZ-së dhe ky manuali në një nga pikat e tij thotë që pasi mbyllet kutia dhe fletët e votimit, pra mbasi është bërë numërimi thotë: “Të gjithë këto zarfe, përfshirë zarfin me procesverbalin e hapjes së votimit, zarfin me procesverbalin e mbylljes së votimit dhe zarfi me procesverbalin e vulosjes futen në kutitë e votimit, të cilat mbyllet me

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

vula, me kode sigurie të reja. Përse nuk i keni orientuar ju GNV-të që këto zarfe ti fusin në fund të procesit në kutinë e fletëve të votimit, por i keni mbajtur ju?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Në fakt i kemi orientuar vazhdimisht që së bashku me zarfet e votimit të futin edhe procesverbalet e mbylljes. Por nga ngarkesa shumë shpesh gabonin, nuk i fushnin brenda dhe na e linin në dosjen tonë që ne e dorëzonin fillimisht në kutinë e votimit. Kjo mund të verifikohet edhe nga kamerat, që realisht nuk i kanë vendosur aty, por i kanë lënë në dosje. Dosje që ne ja japim në dispozicion paraprakisht.

**Z. K. Bele:** Nga vështrimi i disa dosjeve që hapa shoh procesverbalet origjinale 07, 08, 06. Pra tipikisht kjo është ajo që ka ndodhur me këto procesverbale? E keni kontrolluar sa janë, sa nuk e kanë?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Jo nuk i kemi kontrolluar. Disa prej tyre janë kopjet e karbonit, disa janë origjinale, duhen kontrolluar.

**Z. E. Lako:** Dakord! Unë kam hapur katër dhe në të katërta e kam gjetur. Kemi ndonjë pyetje tjetër?

**Z. A. Llangozi, avokat :** Referuar nenit 113 të Kodit Zgjedhor, është e përcaktuar në pikën 6 të këtij neni që procesverbalet origjinal për mbylljen e votimit futen në kutinë e votimit. Ka ndodhur kjo gjë apo kanë qenë të gjitha jashtë kutive të votimit?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Në fakt në shumicën e rasteve ose më mirë të themi në 90 % të rasteve procesverbalet origjinale të mbylljes kanë qenë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

në kutinë e votimit të kryetarit sepse në rast se nuk gjendeshin, normalisht do të vazhdonin me procedurën tjetër që hapet kutia e materialeve. Ato janë gjetur dhe janë nxjerrë jashtë kutisë në momentin e numërimit, këtë mund ta verifikoni nëpërmjet kamerave. Nëse nuk do të ishte procesverbali origjinal apo nuk gjendej, normalisht vazhdon procedura tjetër, hapet kutia e materialeve dhe bën shënimin përkatës.

**Z. I. Rusmali:** Mu krijua konfuzjon tani. Ju thoni në 90% të rasteve kanë qenë brenda në kuti.

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Dëngu që shoh unë këtu më duket i madh. Mund të jetë 20-30 % e totalit. Tani nga kutia si erdhën këtu?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Kanë ardhur pasi grupi i numërimit ka përfunduar procesin e numërimit, nuk i ka futur në zarfet në kutinë e votimit, por i kanë lënë në dosjet tona. Dosjet të cilat ja japim fillimisht grupit të numërimit për të bërë verifikimin me vulat. Nëse nuk do të ishin do të hapeshin kutia e materialeve. Ka tjetër procedurë, ne bëjmë shënim përkatës...

**Z. I. Rusmali:** Pyetja ishte si erdhën këtu? Si i bë dëngu kaq i madh? U bë sepse kur kanë bërë numërimin këtë e kanë lënë jashtë dhe e keni marrë ju.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Jo, e kanë lënë jashtë dhe i kanë futur te dosja që ne vëmë në dispozicion paraprakisht, ku janë procesverbalet e vilosjes, janë marrë materialet në dorëzim. Ne e kemi konstatuar me vonesë në fakt.

**Z. K. Bele:** Më falni ju keni për çdo QV nje dosje të veçantë?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Po, për çdo QV kemi dosje të vecantë. Dosja i jepet në dispozicion grupit të numërimit nga momentin që merr kutinë për të filluar procesin e numërimit kur bën ballafaqimin e vulave.

**Z. I. Rusmali:** Këto janë 64 dosje apo janë më pak?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** 65 QV, sa kemi QV.

**Z. I. Rusmali:** Këto janë 65.


**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** po.

**Z. I. Rusmali:** Dalord, me aq sa e dini ju, pa e kontrolluar ne, këto procesverbale janë në secilën dosje apo janë më pak?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Me çfarë pashë unë, një pjesë janë origjinale, por le të themi 70%-80% ishin kopje karboni.

**Z. I. Rusmali:** Pra ç' do dosje ka procesverbal?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Po, ka procesverbal sepse ajo është 5 kopje në fakt...

**Z. I. Rusmali:** Pra në ç' do dosje ka procesverbal. Një pjesë janë origjinale, një pjesë janë kopje karboni.

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Ata në fakt kopjen e tyre na e vinin në dispozicion. Mund ta mbanin dhe vet një kopje sepse ligji jua lejon dhe këtë të drejtë.

**Z. A. Llangozi, avokat :** Nga data 14 që ka qenë dita e mbylljes së votimit dhe e numërimit, deri ditën e sotme ku kanë qenë këto procesverbale? Kush i ka patur? Në çfarë vendi kanë qenë administruar? Kush ka qenë personi përgjegjës që i ka mbajtur këto procsverbale?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Kanë qenë në zyrën e ZAZ-së 64.

**Z. I. Rusmali:** Nën administrimin e ZAZ-së?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë të ruajtura, domethënë jo të lëna fshehur.

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Patjetër të ruajtura, vendosur edhe në kasafortë.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Si i ruani ju? Kur mbyllni punën ju i fusni në kasafortë?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Po. Kishim kasafortë të pocaçme, kishim kyçin dhe normalisht edhe çelësat nga ana jonë nuk janë dorëzuar ende te personat përkatës për sa kohë procesi nuk është mbyllur.

*Ndërhyrje nga salla pa mikrofon, nuk dëgjohet.*

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Çelsat e zyrës që kishim kur bënim punën në ZAZ. Kishim një zyrë që ishte në afërsi të vendit të numërimit. Nuk ishte tamam aty, por ishte në afërsi.

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-sw:** Pyetja ime është, këto procesverbale, këto që keni mbledhur ju, kanë qenë të firmosura nga të 5-të anëtarët e KZAZ-së? E dyta, ka rreth mbi një javë që është bërë mediatike për disa procesverbale, origjinalet që kanë dalë në media. Ndër këto 65 sa janë që mungojnë origjinalet dhe lind pyetja e paragjyqimit dhe e dyshimit, ju e paskeni ditur dhe ku ta di unë tani që ju këto ditë me procesverbalet e tjera i keni bërë, i keni firmosur ose i keni firmosur këto në kuti që dyshoni që keni bërë këtë gjëmën, ose ky numëruesi që ka dalë, nëse jua ka sjellë këto procesverbale origjinale, pra na tregoni kush është që ta çojmë tamam atë për ndjekje penale.

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Për sa i përket firmosjes, nuk kanë sesi të firmosin anëtarët e KZAZ-së sepse ato janë formularë të QV-së dhe do të duhet ti firmosin anëtarët e komisionit të votimit kështu që nuk ka nens që ti firmosim ne ato. Për sa i përket pyetjes tjetër ideja është që mund të jenë bërë shumë

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

gjëra mediatike. Normalisht unë nuk kam patur detyrimin ligjor të reagoj për secilën prej tyre. Nga mbikqyrja dhe kontrolli që kemi bërë ne si KZAZ kur filloi procesi i numërimit kemi konstatuar që procesverbalet origjinale të mbylljes kanë qenë në kutinë për kryetarin.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Kryetar ky është procesverbali që na intereson neve. Na intereson vetëm ky. Sa veta e kanë firmosur këtë?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Këtë e kanë firmosur 4 persona.

**Z. I. Rusmali:** Kush janë këta?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Është kryetari, sekretari dhe 2 anëtarë.

**Z. I. Rusmali:** Përse nuk e kanë firmosur të gjithë këtë apo nuk ke dijeni?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Duhet të shikoj njëherë në fakt, që komisioni i votimit në këtë rast me sa anëtarë ka qenë sepse kishim vakanca.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Ne nuk e shohim dot, ju e shihni. Na thoni sa ka patur.

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Besoj në pak kohë mund ta verifikoj.

**Z. I. Rusmali:** Jua japim kohën, na jepni përgjigjen.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Dakord! Sa ta verifikoj ju kthej përgjigje.

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-sw:** KZAZ-ja nuk është mbledhur. Para dy javësh kam folur me sekretarin e KZAZ-së, e kam me përgjim këtë dhe më ka thënë që ka marrë të gjithë dokumentat dhe se ku i çoi nuk e di. Nëse do e gjejmë ne këtë procesverbalin, mban përgjegjësi ky, nëse do e gjejmë origjinalin?

**Z. A. Llangozi, avokat :** ...Po të gjejmë të njëjtin proceverbal origjinal. Do të kërkojmë kohë një ditë, do e gjejmë atë procesverbal.

**Z. Y. Merkaç:** Më falni mund të shpjegoj pak procedurën drejtori?

**Z. E. Meta:** Atëherë, Procesverbalet, kryesisht procesverbali që shërben për vulosjen e kutive të votimit dhe për mbylljen e procesit të votimit hartohen në dy versione. Versioni i parë është me kopje kimike dhe versioni i dytë është me printim me ngjyra. Versioni i parë përdoret nga komisioni i QV-së dhe teorikisht duhet të hidhet nga anëtarët e komisionit të votimit në kutinë përkatëse, pra në kutinë e votimit dhe një kopje në kutinë përkatëse në kutinë e materialeve të votimit dhe në kutinë për këshill, ndërsa kopjet e tjera që janë me ngjyra shërbejnë kopje për tu mbajtur nga vetë anëtarët apo vëzhguesit që janë pjesë në këtë proces.

**Z. K. Bele:** Nëse e kuptova drejt. Ai procesverbal është vetëm 1 kopje me ngjyra.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Meta:** Kjo është njëra nga kopjet mesa konstatova unë që është plotësuar nga anëtarët e komisionit të votimit me kërkesën e... që mund ta ketë mbajtur një nga anëtarët...

**Z. K. Bele:** Ka më shumë se një kopje?

**Z. E. Meta:** Ka më shumë se një.

**Z. I. Rusmali:** Pse kjo ka përfunduar në dosjen e KZAZ-së? Këtë na trego. Cila është rruga procedurale që të çon në dosjen e KZAZ-së?

**Z. E. Meta:** Atëherë e shpjegova pak më parë. Procesverbali me kopje kimike, teorikisht kopja e parë origjinale duhet të futet në kutinë e votimit për kryetar bashkie. Kopjet e tjera përfundojnë në kutinë për këshill dhe në kutinë e materialeve zgjedhore. Në rast se ka kërkesa nga ana e anëtarëve të tjerë të komisionit apo nga vëzhguesit, përfaqësuesit e partive politike, kopjet e tjera plotësohen nga komisioni dhe u jepen palëve.

**Z. I. Rusmali:** Nga KQV-ja.

**Z. E. Meta:** Gjithmonë nga KQV-ja. Rasti konkret kemi një set me 4 kopje dhe kopja e parë hidhet në kutinë për kryetar bashkie në zarf, nga këto...

**Z. I. Rusmali:** Ne kemi gjetur vazhdimisht, gjithmone që kemi bërë hapje kutish kemi gjetur kopjen rozë brenda, përse kemi gjetur rozën brenda dhe nuk kemi gjetur atë tjetrën?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Meta:** Kjo është në varësi të momentit si e kanë hedhur anëtarët e komisionit të QV-së.

**Z. I. Rusmali:** Roza është kopje karboni, nuk është origjinali.

**Z. E. Meta:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Dakord!

**Z. Y. Merkaç:** Ka dhe 3 kopje të tjera me këtë ngjyrë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord! Keto 3 kopje me këtë ngjyrë, po i quajmë origjinale, janë kopje që komisioni i bën për ti futur në kuti? Si rregull origjinalja futet në kuti apo jo? Një kopje që komisioni e bën për shkak se ka bërë më shumë se 7 dhe ja ka dhënë dhe vëzhguesve dhe i ka ngelur origjinali vetë.

**Z. E. Meta:** Ajo që shpjegova pak më parë ishte dhe procedura. Pra kopja e parë e setit kimik futet në kutinë e votimit. Pra teortikisht origjinali duhet të jetë në kutinë e votimit. Kopjet e tjera që janë të ptintuara jepen për vëzhguesit apo përfaqësuesit.

**Z. I. Rusmali:** Pra janë më shumë se 7. Janë 1x7, 2x7 dhe mund të jenë dhe 3x7. Dakord, pyetja që kam unë tani është 1x7, 2x7, 3x7 në këtë qendër votimi janë me 4 firma apo me më shumë?

**Z. E. Meta:** Duhet verifikuar, nuk mund ta them.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Bashkë me kryetarin a mund ta verifikoni ju lutem? Ju lutem juve ju kemi kërkuar të na jepni varjantin tuaj. Zoti Lefter na thatë që mund të na servirni një kopje me më shumë firma. Na e servirni dot? Ne e dimë që kanë funksionuar qendra me 4 anëtarë. Ju nuk na ndihmoni me këtë. Ne na duhet vetëm të na konfirmoni që kjo qendër votimi ka funksionuar me 4 anëtarë apo ka funksionuar me 7 anëtarë? Na jepni dot ndihmë për këtë apo jo?

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Jua jap unë përgjigjen, në dijeninë time të plotë edhe të Bashkë Fitojmë, edhe të PL-së që janë 3, edhe të PSD-së, 4 që i di unë, që janë të plotësuar në mënyrë unanime, kanë qenë të pranishëm, përveç... nëse nuk ka shkuar Partia Socialiste...

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Nga verifikimet që bëra për këtë qendër, ka funksionuar me 5 anëtarë. Kryetari ka qenë përfaqësuesi i PD-së, sekretari zoti Kristaq i PS-së, anëtar i PS-së Rajmond Ndreu dhe anëtar tjetër i Koalicionit Bashkë Fitojmë zoti Barjam Shkurti. Të katërt këta kanë firmosur. Nuk ka firmosur vetëm anëtari i PSD-së zoti Mariol. Ai ishte në kuorumin për plotësimin (*nuk dëgjohet*). Jemi njoftuar për mungesën e dy anëtarëve dhe të plotësohet kuorumi. Kemi zbatuar procedurën për të njoftuar subjektet politike përkatëse brenda afatit. Në momentin që nuk e kanë paraqitur brenda afatit ligjor, por kuorumi plotësohet dhe normalisht ka vazhduar procesi i votimit. Ka qenë pjesë, nuk ka firmosur, në kopje janë 4 anëtarë që kanë firmosur. Ka firmosur edhe përfaqësuesi i Koalicionit Bashkë Fitojmë, zoti Barjam Shkurti.

**Z. E. Lako:** Faleminderit në këtë faze nëse nuk kemi ndonjë pyetje...

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi, avokat :** Nga ana juaj u tha se ky material zgjedhor ka qenë nën administrimin e kujt?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** KZAZ-së.

**Z. A. Llangozi, avokat:** Në çfarë vendi ka qenë KZAZ-ja?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Qendra Kulturore “Kristaq Laçka” është si vendndodhje.

**Z. A. Llangozi, avokat :** Juve e keni akoma dhe sot çelësin?


**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Po. Zyrë e KZAZ-së thamë. Objekt ndryshe nga vendi i numërimit.

**Z. A. Llangozi, avokat :** Kush i ka patur çelësat e këtyre materialeve? Keni patur të gjithë nga një kopje apo e keni patur vetëm ju?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Një kopje sekretari dhe një kopje unë si kryetar, dy kopje.

**Z. A. Llangozi, avokat :** Nga konsultimi që kam bërë me kandidatin, ditën tjetër do të sigurohej një procesverbal ndryshe nga ky procesverbal që është.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Pyetja ime është, nëse do të gjendet procesverbal tjetër me të 7 firmat apo me 6....Kush e mban përgjegjësimë për fletën tjetër? Ku e kanë gjetur?

**Z. K. Bele:** Përgjegjësinë se kush e mban e zgjidh ligji dhe hetohet rast pas rasti. Ne këtu nuk jemi për të gjetur kush e ka përgjegjësinë për çfarëdolloj shkelje që kemi. Ne kemi një proces, ecim me provat tona. Kishim një provë që për ju ishte e rëndësishme, e vlerësuam maksimalisht. Shtymë procesin, sollëm kryetarin bashkë me dokumentacionin. Për hir të së vërtetës kjo na ndihmoi dhe ne sepse pamë procesin në një këndvështrim tjetër, kuptuam më shumë dhe jemi këtu sot në këtë moment që kemi të njohur këtë dokumentacion që nuk e kemi administruar në kuptimin procedural. Tani të vazhdojmë me pyetjet për këtë moment procedural dhe të vazhdojmë me procesin kur të mbarojmë këtë.

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për kryetarin e KZAZ-së. Ju thatë që në mëngjes është plotësuar kuorumi, ka qenë anëtari i PSD-së apo jo?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Jo në fakt procedura e kërkon që kur komisioni qendror konstaton që nuk janë të pranishëm të gjithë anëtarët njofton KZAZ-në përkatëse. Jemi njoftuar kur ishim në votim. Ishin paraqitur, në dijeninë time vetëm 5 anëtarë. Normalisht kemi zbatuar procedurën. Duke njoftuar subjektet përkatëse politike që kishin të drejtë qer të paraqitur propozimet. Nuk është paraqitur brenda afatit ligjor. Kanë vazhduar normalisht sepse ishin mbi kuorum, pra ishin mbi 4 anëtarë.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Braho:** Kjo është arsyeja që nuk ka nënshkruar te kjo KQZ 07? Pra ka shkuar me vonesë në QV. KQZ 07 normalisht është fleta e parë që hidhet në kuti apo jo?

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** Nuk e di përse nuk ka firmosur. Ne jemi njoftuar që janë caq anëtarë, pra që nuk ishin 7 anëtarë.

**Z. K. Bele:** Për këtë çështje ka pyetje të tjera?

**Z. A. Llangozi, avokat :** Si na e provoni ju që këto materiale kanë qenë në KZAZ dhe jo diku tjetër?

**Z. I. Rusmali:** Përse duhet të provojë ai që nuk kanë qenë diku tjetër kur ju nuk keni prova që nuk kanë qenë diku tjetër?

**Z. A. Llangozi, avokat :** Sipas ligjit, e theksova dhe më parë, neni 113 duhet të ishin në kuti.

**Z. K. Bele:** Ai shpjegoi sipas rastit herë hidhet origjinali herë kopja e karbonit. Ne siç e përmendëm në shumicën e kutive kemi parë kopjen rozë kur i kemi hapur. Duke thënë këtë sot u relatua fakti që në kuti në një numër të konsiderueshëm rastesh, nuk e di sa përqind, është hedhur kopja rozë. Ne kemi këtë kopje që ne e konsiderojme origjinale për sa kohë nuk provohet e kundërta. Pra ky është një moment që u verifikua. Nëse keni diçka tjetër për të shtuar për këtë gjë. Jemi në një pikë që kjo u pranua nga pala.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi, avokat :** Unë do të kërkoja një kopje të të gjitha procesverbaleve. Sepse shumica më rezulton e shkruar dhe e nënshkruar nga i njejti person nga ato që unë pashë. Më duhet një kopje se ndoshta zotëria i ka shkruar e nënshkruar vet, përderisa nuk kanë qenë nën administrimin e gjithë KZAZ-së, por kanë qenë nën administrimin e një personi ose dy, unë dyshoj... kam parë procesverbale të shkruara dhe nënshkruara nga i njejti person, ajo duket qartë, gjithsesi kërkoj një kopje të të gjithë materialeve që u paraqitën sot.

**Z. K. Bele:** Avokat, ju kishit një provë, e cila nuk është kjo provë që solli një person. Ne në mbështetje të hetimit tonë kërkuam të na silleshin këto dokumente. Këto u sollën dhe ne i kqyrëm për ti parë për bindjen tonë, për të ndihmuar dhe hetimin e çështjes. Duke e thënë këtë ne nuk e pranojmë që ju të merrni kopje të këtyre akteve se këto janë akte që i kanë të gjitha palët në proces, vetëm nga natyra nuk janë tashmë fakte që kanë ndonjë lloj sekreti, por në këtë fazë të procesit ne do të vazhdojmë me diskutimin për provat që ju keni sjellë dhe duhet të ecim me procesin. Pra për sa u relacionua keni pyetje të tjera? Nëse jo vazhdojmë me pjesën tjetër të diskutimit.

**Z. A. Llangozi, avokat :** Jo nuk kemi pyetje të tjera.

**Z. K. Bele:** Faleminderit! Vazhdojmë me pjesën tjetër të diskutimit. Pra folëm për pjesën e videove që ju na kishit vënë në dispozicion dhe ky ishte momenti ku ne u ndalëm. Ju rikujtoj që diskutuam faktin që ato janë të njohura për ne dhe në këtë fazë...

**Z. A. Llangozi, avokat :** Meqenëse zoti Shushari ndodhet sot këtu a mundet ti bëj një pyetje.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Me çfarë lidhet?

**Z. A. Llangozi, avokat :** Me KZAZ-në.

**Z. K. Bele:** Dakord!

**Z. A. Llangozi, avokat:** Me detyrën në KZAZ-në 64. Në vendin ku KZAZ-ja ka mbajtur materialin zgjedhor dhe kutitë e votimit, ka dy hyrje apo ka një hyrje, sa dyer ka ky ambjent?

**Z. K. Bele:** Flisni për VNV-në?

**Z. A. Llangozi, avokat :** Po.

**Z. E. Shushari, kryetar i KZAZ-së 64, Kuçovë:** VNV-ja ka vetëm 2 hyrje përballë. Ka një ambjent tjetër që e lidh me VNV-në që kanë lidhje me një shkollë, ajo është një derë e kyçur, e mbyllur me etiketë, ka një dollap super të madh, praktikisht derë e mbyllur prej vitesh. Dy hyrje funksionale përballë. Janë hyrje plotësisht të ndriçuara. Ne morëm masa me bashkinë që të ishin komplet të ndriçuara, që të dukej gjithçka çfarë ndodhte brenda, me dritare të hapura nga pamja ballore.

**Z. I. Rusmali:** Kryetar në këtë derë anësore... Ka një derë anësore aty apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Në një ambjent që është në afërsi të VNV ka një derë tjetër po.

**Z. I. Rusmali:** Ne nuk e njohim vendin duhet ta imagjinojmë. Ju keni një sallë të madhe ku rrinë kutitë. Salla e madhe ka dy hyrje ballore dhe duket sikur ka një derë anësore apo jo?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Përballë ka dy hyrje si e thashë.

**Z. I. Rusmali:** Ka dy hyrje, po anësore ka një derë na kanë dhënë fotografinë këta.

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po është një derë e kyçur.

**Z. I. Rusmali:** Është e kyçur sipas jush, çfarë çelsash keni ju? Çfarë dere hapni ju si komision?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Ne hapim vetëm ato dyert përballë. Të dyja dyert përball.

**Z. I. Rusmali:** Të dyja dyert, për secilën derë keni çelës?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Presupozohet një kryetari dhe një sekretari,

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po. I kemi të gjithë kopjet.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Për derën anësore nuk ka.

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Nuk kemi çelës për atë.

**Z. I. Rusmali:** Ajo derë është e mbyllur me drynë.

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Me drynë, po. E kyçur me drynë, ajo ka një dollap super të madh në fakt që është për ta bllokuar.

**Z. I. Rusmali:** Mos na trego gjëra që janë irrelevante. Na duhet është e mbyllur me drynë nga jashtë? Jo nga brenda?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po, është e kyçur, po.

**Z. I. Rusmali:** Nga jashtë?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Ai dryni si të duket, të duket i sigurtë ty?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Ajo në fakt duhet të kuptojmë si VNV ka qenë i përhershme. Në çdo zgjedhje ky ka qenë VNV dhe i plotëson të gjitha standartet të sigurisë dhe është miratuar dhe nga KQZ si VNV.

**Z. I. Rusmali:** Dhe dera ka qenë gjithmonë atje?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Gjithmonë aty, nuk është se është derë rishtazi.

**Z. I. Rusmali:** Në dijeninë tendë kush e ka çelsin e asaj dere?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Nuk e di, ndoshta drejtori i shkollës. Nuk e kam idenë se kush mund ta ketë.

**Z. I. Rusmali:** VNV çfarë është, është palestër shkolle?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** VNV është Qendra Kulturore e Fëmijëve.

**Z. I. Rusmali:** Po pse jo drejtori i Qendrës Kulturore të Fëmijevë po drejtori i shkollës?


**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po, siç e thashë VNV kishte dy ambiente, këtë sallën e madhe ka edhe një ambient tjetër që është pjesë e shkollës, e Shkollës Myrteza Kepi.

**Z. I. Rusmali:** Çfarë bëhet në atë ambientin aksesor?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Aty zakonisht vendosin materiale, Shkolla Myrteza Kepi e përdor si magazinë.

**Z. I. Rusmali:** E përdorin si magazinë nuk bëjnë stërvitje, nxënësit aty, nuk bëjnë mësim?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Jo.

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Tani, kjo është dera e Qendrës së Kulturës, Bashkisë Kuçovë, çelsat i ka drejtori me stafin e tij. I Qendrës së Kulturës së bashkisë. Jo, i shkollës. I Bashkisë Kuçovë dhe është me dy dyer, dera e jashtme që është ngjitur me derën e KZAZ-së dhe nga brenda ku ishin kutitë derë tjetër. Tani më fal, po flas për derën anësore dhe dera tjetër që është tek kutitë brenda KZAZ-së me dy dyer. Tani brenda tek Qendra e Kulturës kanë pasur edhe materiale këta, të KZAZ-së nuk e di se çfarë mbanin aty. Tek kjo magazina gjasme në thonjza dhe kjo materiale, kamera ku di unë sed çfarë ka pasur aty brenda....

**Z. I. Rusmali:** Çfarë materialesh keni pasur aty brenda?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Aty në magazinë kemi vendosur, pajisjet PEI dhe kamerat.


**Z. I. Rusmali:** Pajisjet PEI dhe kamerat, po ne në fotografi kemi parë kutitë?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Kutitë janë tek salla e madhe e Numërimit të Votave , nuk është tek kjo dhoma tjetër.

**Z. I. Rusmali:** Zoti Maliqi ne kemi parë kutitë edhe derën?

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Brenda derës janë këto materialet që thotë ky, e Qendrës së Kulturës. Tani kjo Qendër Kulture përveç derës që është e lidhur me kutitë e KZAZ-së, derë të brendshme ka dhe derë të jashtme që këta e kanë

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

mbyllur me shirit. Po tek kjo Qëndër e Kulturës, se kjo është me tre dyer, është nam i zi tek kjo. Po them derën që është tek kutitë. Anësore është tjetër gjë, është me dy dyer.

**Av. A. Llangozi:** Bëhet fjalë për atë derën që kemi sjellë në foto që është e hapur. Ajo është në mes të ambjentit, aty kanë qenë kutitë, në atë vend në atë vend kanë qenë kutitë.

**Z. K. Bele:** Ta përmbledhim se u ngatërruam.

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për kryetarin e KZAZ-së. Kjo dera me drynë nga jashtë, ku e kishit ju garancinë që në momentin që mbyllet po nga jashtë tha, është e kyçur. Ai që kishte çelsin e këtij drynit mund ta hapte derën e KZAZ-së kur nuk kishte njeri brenda?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Të shpjegoj diçka nëse me lejoni. Ideja është që e gjithë KZAZ-ja dhe nga brenda ka qenë plotësisht e ndryshuar. Madje ndoshta edhe për pak ilaritet, unë kam gjetur një ambjent të ndriçuar edhe ambjentin brenda ku ishin kutitë e votimit. Nuk e di e kanë sjellë përfaqësuesit e “Bashkë Fitojmë” nuk e di kush e ka sjellë. Madje kur bëmë atë pushimin e shkurtër, përfaqësuesja e Bashkë Fitojmë dhe sekretari nuk janë larguar në fakt. Dy anëtarë kanë qenë të përhershëm aty.

**Z. I. Rusmali:** Kjo është interesante, është e rëndësishme në dijeninë tonë VNV ka kamera vëzhgimi, keni pasur ju kamera vëzhgimi, atë që shikon nga lartë?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po kishim një kamer vëzhgimi 360 gradë live stream...

**Z. I. Rusmali:** Në rregull kamera e vëzhgimit kishte pamje atje ku ishin vendosur kutitë dhe eventualisht atje ku dukej kjo dera?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Në dijeninë time po, sepse është i njëjti ambjent dhe është një ambjent i gjithi. Pra, atje ku ishin kutitë e votimit dhe aty ku bëhej edhe numërimi.

**Z. I. Rusmali:** Kamera e vëzhgimit ka pasur ndërprerje të sinjalit ndonjëherë?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Jo, nuk ka pasur asnjë herë, kamera 360 gradë. Kamera ka qenë e vendosur sipër monitorëve, pra atje është e vendosur nuk ka pasur probleme teknike.

**Z. I. Rusmali:** Avokat ndonjë koment në lidhje me atë që thotë zotëria?

**Av. A. Llangozi:** Komenti i parë është që duket qartë që aty në atë vend ku ndodhet ajo derë dhe ku janë kutitë e votimit nuk ka kamera, nuk ka mbulim me kamera me pamje filmike.

**Z. I. Rusmali:** Kryetari tha, në dijeninë time ka mbulim me kamera, për pjesën ku vendosen kutitë. Ju thoni nuk ka...

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.06.2023*

*Av. A. Llangozi:* Mos kanë qenë pamje filmike të tjera që nuk ka qenë i detyruar ti sillte këtu....

*Z. I. Rusmali:* Një sekond se do ta provojmë ne. Ju thoni që nuk ka mbulim me kamera, kamera vëzhguese e VNV nuk e mbulon këtë zonë?

*Av. A. Llangozi:* As derën ku bëhet fjalë që ne kemi sjellë, as zonën.

*Z. I. Rusmali:* Pamjet e kameras vëzhguese të VNV-së mund të na i jepni ju?

*Av. A. Llangozi:* Po i kemi, i kemi dhënë edhe për kqyrje këtë rast.

*Z. I. Rusmali:* Mund ti shohim?

*Av. A. Llangozi:* Po patjetër.

*Z. L. Braho:* Të rimë pak tek kjo dera. Tani këto dy dyerë e tjera, normalisht i keni siguruar ju me çelsa besoj gjatë periudhës që ka funksionuar si KZAZ. Po për këtë derën e tretë morët masa ju që ti vendosnit ndonjë drynë ekstra?

*Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:* Jo, drynë ekstra nuk i kemi vendosur.

*Z. L. Braho:* Pra, ajo derë ka qenë e lirshme për tu hapur, nga personi që kishte çelsin edhe gjatë kohës që ky ambjent ka funksionuar për KZAZ?

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Do të them edhe diçka tjetër që normalisht është edhe e procesit. Në momentin që ne jemi larguar për një pushim të shkurtër përfaqësues të Bashkë Fitojmë edhe të kandidatit atje, ishin vendosur të gjithë në dritaret e VNV. Kur kam ardhur unë aty i kam gjetur të gjithë në dritare. Pra, me sy të lirë ata mund të shikonin kutitë e votimit dhe çdo gjë aty.

**Z. L. Braho:** Dritaret nga jashtë?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Ka tre dritare përballë VNV ku mund të shikosh edhe kutitë e votimit dhe shumë përfaqësues në fakt të koalicionit Bashkë Fitojmë dhe të kandidatit që ishin të vendosur të gjithë pranë dritareve dhe rrinë të gjithë të varur atje. Kur kam ardhur unë, kam gjetur shumë persona atje.

**Z. I. Rusmali:** Unë mund të gabojë nga memoria se na janë bërë shumë ngjarje dhe na janë ngatëruar me njëra tjetrën. Keni thënë ju, diku në pretendimet tuaja që ka pasur një ndërprerje na e sqaron dot pak?

**Av. A. Llangozi:** Është ngritur shkak pa vlefshmërie vendimi...


**Z. I. Rusmali:** Na e sqaroni pak këtë historinë e ndërprerjes që të pyesim pak kryetarin për ndërprerjen.

**Av. A. Llangozi:** Një pyetje, përpara se të jap këtë shpjegim mund ti bëj?

**Z. I. Rusmali:** Nuk do, nuk do të ndjekesh shqetësimin tim?

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

*Av. A. Llangozi:* Është marrë një vendim nga...

*Z. I. Rusmali:* Të lutem, këtë!

*Av. A. Llangozi:* Është marrë një vendim i kundraligjshëm që ne kemi ngritur si pretendim, është marrë një vendim që do të ndërpritet numërimi nga ora 11 e 30 e mbrëmjes deri në 12 e 40.

*Z. I. Rusmali:* Vendimi për ndërpreje nga ora 11 e mbrëmjes deri në 12 e 40 të natës pse është marrë?

*Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:* Në fakt ora e pushimit është marrë nga ora 11 e 20 deri në 12:00. Në 12 e 30-40 filloi procesi i numërimit për shkak se pati vonesa dhe anëtarëve të GNV-ve. Në fakt u kërkua më së shumti nga anëtarët zonja që ishin të KZAZ-së për shkak të lodhjes së tepruar. Ju kujtojmë të nderuar anëtarë të KAS-it që ....

*Z. I. Rusmali:* Nga ora 11 e 20 deri në 12 e 40 si e siguroat VNV-në?

*Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:* VNV ishte plotësisht e ndriçuar, e kyçur pra me vula etikete që jemi furnizuar nga KQZ, dritaret, tre dritare ballore të VNV ku mund të shiheshin lehtësisht kutitë e votimit ishin të hapura, ishin transparente, plotësisht të ndriçuara. Tre dritaret ballore janë të siguruara me hekur ndërkohë dy dritaret pas VNV-së janë të murosura pra janë të mbyllur si dritare, dhe tre dritaret ballore janë dhe janë me zgavra metalike.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Në rregull dyert ballore ju i siguruat me vula, po kësaj derës anësore çfarë i bëtë?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Ajo dera në fakt, duhen të gjithë këta burrat këtu për të zhvendosur dollapin atje, sepse është një dollap super i madh i bllokuar që...

**Z. I. Rusmali:** Nuk me intereson dollapi, na intereson çfarë i bëtë derës nga jashtë i vutë vulë derës, nga brenda është me dollap, nga jashtë si është? Nga jashtë kishte vulë? Se dy dyerve ballore i vutë vula nga jashtë shirit vula imagjinoj unë.

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Shiritat etiketat e sigurisë diçka e tillë e kuqe.

**Z. I. Rusmali:** Që po të hapej të merrej vesh që është hapur. Derës anësore çfarë i bëtë?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Dera thjesht ishte e mbyllur.

**Z. I. Rusmali:** Nuk kishit vula për derën anësore apo nuk ju shkoi mendja?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Nuk na shkoi mendja me thënë të drejtën.

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Unë kam qenë i varur atje tek hekurat se të tjerët nuk vinin dot, cava edhe rrethimin e policisë erdhën edhe dy të OSBE/ODIHR në momentin që vajta unë. Ia thamë se çfarë kanë bërë nuk e di. Tani, unë kam hapur perden e dritares dhe nuk i shikoja dot. Të vij ky bashkë me mua e ti shikoj. Kam

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

parë dy rreshta, por rreshtin e fundit edhe derën ngjitur unë nuk e shikoja dot edhe ai dollapi i lëvizshëm mbrapa nuk i shikoja dot. Tjetra përsëri e sfidoj kryetarin, tha që kanë qenë brenda sekretari dhe anëtari i KZAZ-së ka qenë aty brenda dhe këta kanë marrë një vendim, se vjen anetarë e KZAZ-së përfaqësuese e PL-së vjenë për të më njoftuar mua në momentin që del jashtë këta menjëherë mbyllin derën dhe më thotë, morën vendim për tu larë gjysëm ore. Pra vendimi i këtyre ishte për tu larë gjysëm ore dhe kanë ardhur në 1 pa 20. Prandaj dhe unë ju them që të gjitha këto fakte që kemi thënë, unë kur të doni ju, ju them. Unë sytë besoj që mirë i kam edhe patentën e kam të rregullt pa syze, shikoja vetëm dy rrjeshta. Dëgjoja zhurma dhe unë dhe anëtarja e KZAZ-së.

**Z. I. Rusmali:** Lefter këtë që e thua ti e konfirmon edhe kryetari. Edhe kryetari thotë në 12 e 40 filluam. Ti thua në 1 pa 20, ky tregohet të kundërshton thotë 12 e 40, e njëjta orë është.

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Ne në orën 12:00 kemi qenë pranë VNV-së. Pra, procesi i numërimit ka filluar sepse pati vonesa, plus edhe procesi i verifikimit të anëtarëve dhe vëzhguesve. Pra, ai proces bëhet bashkë me policinë na vonojë goxha kohë.

**Z. I. Rusmali:** Ka një procedurë ajo. Avokat!

**Av. A. Llangozi:** Ju pasi morët vendimin në 11 e 30 që ju do bënit një orë pushim dhe jeni kthyer në 12 e 40 mund të na thoni fiks se në çfarë ore jeni futur brenda në KZAZ.

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Rreth orës 12 siç e thashë.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Në 1 pa 20 janë futur këta. Kemi qenë të gjithë aty.

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, këtë vendimin që morët juve, pati kontestime ky vendim? Sa veta ishit ju si KZAZ?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Jo, nuk pati. Ne shtatë anëtarë plus sekretari.

**Z. I. Rusmali:** Sekretari nuk ka vendimmarrje, duhet të mbajë shënime. Ju ishit 7 anëtarë dhe vendosët ta shtynit një orë, e protokolluat vendimin?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po tek libri i protokollit të mbledhjeve është bërë shënimi përkatës.

**Z. I. Rusmali:** Tek libri i protokollit të mbledhjeve po ta kërkojmë e gjejmë?


**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po.

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Më fal kur është protokolluar se në moment nuk ka firmosur njeri? Nuk ka firmosur njeri, e kanë firmosur mbrapa këta.

**Z. I. Rusmali:** Kur është protokolluar.

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Ne normalisht në momentin që marrim vendimin kemi një libër protokollit mbledhje, sekretari bën shënimet përkatëse

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

sipas vendimmarrjes dhe ne vendosim në fund të librit të protokollit emër mbiemër firmë. Siç është procedura.

**Z. L. Braho:** Për këtë hapjen dhe mbylljen e KZAZ-së por kur u kthyet morët ndonjë vendim tjetër për të rifilluar procesin me orë?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po në momentin që ne u rikthyem vendosëm për të filluar procesin e numërimit...

**Z. L. Braho:** Është në libër protokollu kjo?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po është, patjetër që është. Patëm vonesa siç e thashë dhe për të ardhur të gjithë anëtarët e GNV-së për të bërë lajmërimet përkatëse. Gjithashtu patëm edhe goxha vonesa me verifikimet jo vetëm anëtarët e GNV-së por më shumti vëzhguesve, e cila policia do ti identifikonte pra dikush nuk kishte kartën e identitetit do shkonte tek makina. Patëm një vonesë për 30 minuta për këtë shkak.

**Z. K. Bele:** Mesa shoh edhe nga libri i protokollit ka një shënim në orën 24:00 ka dhe një shënim në orën 00:30 apo është data 15 ne jse thjesht për të mbështur atë që tha...

**Z. I. Rusmali:** Po të shohim në ekran të gjitha palët, ajo është kamera 360 gradë e VNV-së?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po ajo është.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. K. Bele:** Shikojmë dhe 5 tavolina numërimi aty.

**Z. I. Rusmali:** Ajo i shikon të gjitha kutitë?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po të gjitha, po të shikoni ku është ai shënimi festat aty janë të gjitha kutitë tona. Majtas ekranit.

**Z. I. Rusmali:** Nuk na duhet dera, a shikohen të gjitha kutitë. Jashtë këtij këndi ka kuti të tjera?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Jo nuk ka kuti se është një ambjent i nderuar anëtarë, është një ambjent i gjithi në total.

**Z. I. Rusmali:** Rreshti i tretë është ai aty që shohim ne. Mund të dali kryetari aty të na e tregojë atje.

**Av. A. Llangozi:** Mbrapa kutive është dera, që lidhet me reshtin e tretë.

**Z. E. Lako:** Ai që mund të ketë hyrë, nga ku mund të ketë hyrë na e shpjegoni?

**Z. I. Rusmali:** Kutitë shikoni, janë të dukshme kutitë?

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Të bëj një pyetje, a është e vërtet që ne ishim rreth 500 veta qytetarë nga pala e këtyre ishte vetëm deputeti, kryetari i bashkisë dhe ja 3 drejtora. Në 11 e 20, kanë marrë urdhër politik se në 11 e 20 kanë ikur

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

edhe ata, na lanë vetëm atje, ky me kë ka ardhur? Me kë ka ardhur në 1 pa 20 se ka ardhur bashkë me kryetarin e bashkisë. E dyta, që e mendojë vendimtare prapë, marr informacion nga qytetarët pashë një oficer policie nga Tepelena si fytyrë edhe unë ndërhyjë dhe them kush është ky, filluan konflikte këta dhe na morën na dhanë një përgjigje, e ke ngatërruar thotë se ky është operatori i KQZ-së e ke ngatërruar si njëri ka ardhur nga Pogradeci dhe mbas kësaj ikën. Pyetja tjetër, drejtori i Qendrës së Kulturës, ky që ka çelsat e kësaj çdonte aty në orën 11, në 11 e 10? Çava kordonin e policisë unë prapë, me çantë ky...

**Av. A. Llangozi:** I kemi me foto tua tregojmë pak...

**Z. I. Rusmali:** Nëse mund ta kuptojmë ne po përpiqemi ta kuptojmë se kush është situata. Ju ishit rreth 500 qytetarë aty, këta nuk ishin. Si 500 qytetar kishit mundësi të observonit atë derën anësore çfarë është ajo? Apo nuk e shihnit dot?

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Sepse këta, ky i Qendrës së Kulturës me këtë dollapin e lëvizshëm. Nuk janë futur nga jashtë ata, janë futur nga brenda, janë futur nga shkolla. Shkolla ishte e ruajtur me dy polic tek dera...

**Z. I. Rusmali:** Ajo dera është me drynë nga jashtë, ju ishit 500 veta aty. Këtë derën me drynë nga jashtë e shihnit apo nuk e shihnit?

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Atë nga jashtë e shihnim. Por dera e brendshme...

**Z. I. Rusmali:** Çfarë është dera e brendshme se na nxore katër dyer?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** Sepse dera e brendshme është me kutitë e votimit brenda KZAZ-së që nuk duket. Keni parë Qëndër Kulture me tre hyrje.

**Z. I. Rusmali:** Të lutem shumë, brenda futesh nga jashtë, nuk futesh nga brenda.

**Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:** I nderuar zoti Rusmali, kjo Qëndër e Kulturës se ju keni qenë Ministër Drejtësie dhe na keni kontrolluar ne. Kjo Qëndër Kulture është sa një biruc, dhe me tre hyrje. Derë e jashtme, derë nga brenda tek KZAZ-ja edhe me dollap gjasme me mur të hapur.

**Z. I. Rusmali:** Paska qenë strehim dhelprash nuk paska qenë Qëndër Kulture.

**Av. A. Llangozi:** Pak më parë deklaruat që ju morët masa, me gjithë bashkinë për të rregulluar ambjentin, çfarë masash, çfarë rregullimesh keni bërë dhe cilat kanë qenë punimet specifike që ju keni kryer në këtë rast?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Kemi punuar me pjesën e jashtme të ndriçimit, ndriçimin e jashtëm dhe ndriçimin e brendshëm. Pra, që çdo gjë të ishte transparente. Nëse mund të përgjigjem me diçka në lidhje me atë çfarë tha kandidati, normalisht pretendimi për një polic nga Tepelena ne në fakt e verifikuam dhe bëhët fjalë për zotin Aurel Plaku është një trajnues i KQZ-së.

**Av. A. Llangozi:** Përgjigje që unë nuk mora përgjigje domethënë.

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po kemi marrë masa me bashkinë për ndriçimin e jashtëm dhe ndriçimin e brendshëm.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

*Av. A. Llangozi:* Pyetje tjetër thatë për këtë dollapin që ishte shumë i madh i rëndë e të tjerë, e provuat ju për ta lëvizur? Kur e keni provuar? Sa veta keni marrë pjesë për ta lëvizur?...është pyetje shumë serioze se është e monitoruar me kamera nuk duket.....

*Z. L. Maliqi, kandidat i BF-së:* E ka provuar anëtarja e KZAZ-së përfaqësuese e PL dhe lëvizte dollapi.

*Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:* Nuk e provuam me thënë të drejtën se shumicën e anëtareve e kisha zonja dhe nuk e provova. Po të ishin burra ndoshta do ta kishin provuar. Kishte materiale që mbante shkolla.

**Rifillon Mbledhja**


**Ora 20:00**

*Z. K. Bele:* Riçelim seancën besoj se pyetjet për këtë moment të hetimit u ezauruan ishin shteruese, palët mbajtën qëndrimet e tyre.

*Av. A. Llangozi:* Unë kam edhe një pyetje të fundit edhe nuk dua më. Ju zoti Shushari thatë që jeni larguar nga KZAZ-ja në orën 11 e 30 dhe keni marrë masa dhe numërimi ka filluar në 12 e 40 ?

*Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:* Jam larguar me sa më kujtohet rreth orës 11 e 20 në orën 12 pasi jam rikthyer kemi vendosur të fillojmë procesin e numërimit

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

pati një diferencë nga ora 12 deri në 12 e 30 a 12 e 40 për shkak se të paraqiteshin të gjithë anëtarët e GNV-ve dhe verifikimin e hyrjeve të të gjithë vëzhguesve të ishin të akredituar. Pra, bëhej një proces me policinë , identifikohesh me karta identiteti dhe me bexhet përkatëse. Normalisht si Koalicion “Bashkë Fitojmë” kishin një numër më të madh të vëzhguesve dhe sigurisht që donin kohën e vet verifikimet përkatëse.

*Av. A. Llangozi:* Në çfarë ore jeni futur brenda në KZAZ-së?

*Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:* Rreth orës 12:00.

*Av. A. Llangozi:* Pse e keni shënuar në vendim që jeni futur në 12 e 40?


*Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:* Jo nuk kam shënuar gjë. Për procesin e numërimit po.

*Z. L. Maliqi kandidat i BF-së:* Këta janë futur në 12 e 37 2 minuta e 59 sekonda atëherë jemi futur ne të tjerët.

*Av. A. Llangozi:* Ndërkohë nga pamjet filmike rezulton se në orën 12 e 19 minuta është futur një grup, ajo duket e qartë edhe në pamjet filmike deri në orën 12 e 40 janë marrë me kutitë se çfarë është kryer aty nuk kuptohet por pamjet duken qartë.

*Z. K. Bele:* Për këtë që thotë avokati keni qëndrim, në kujtesën tuaj se ne ju kemi thirur për tjetër gjë po me që se po ju pyesim?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Nuk di që në VNV të jenë futur persona të paaautorizuar përveç anëtarëve të KZAZ-së . Ne bëmë edhe sistemin e kutive të votimit sipas numrit rëndor. Në fakt se ligji kërkon që ne të fillojmë nga numri rëndor më i vogël deri tek numri më i madh. Bëmë një risistem të tyre me qëllim që ti gjejmë kollaj për ti shpërndarë në grupet e numërimit.


**Z. K. Bele:** Vazhdojmë me pjesën tjetër të videove, nëse keni ndonjë gjë për tu thënë. Në fakt mu duk sikur u ezaurua gjithësesi ...

**Av. A. Llangozi:** Në lidhje me videon që ka të bëjë me KZAZ-në nuk kemi as pyetje por ne ju provojmë ju që kutitë e votimit nuk duken fare. Domethënë provohet me pamjet filmike dhe nga 5 tavolina dy nuk kanë vëzhgim të qartë se çfarë është bërë gjatë numërimit nuk kuptohet fare se çfarë është votuar, çfarë veprimesh kanë kryer anëtarët. Një kohësisht na rezulton se janë futur edhe fletë votimi nga jashtë gjë këtë e kemi...

**Z. K. Bele:** Kjo është kamera 360 gradë vëzhguese nga sipër, ku ne shohim 5 tavolina por për shkak të formës ato dy të qëndrës janë më të mëdhaja dhe vijnë duke u zvogëluar. Ka kamera të tjera në tavolinat e numërimit ku bëhet procesi?

**Z. Y. Merkaç:** Në çdo tavolinë numërimi ka kamera që lexohen votat, kjo është thjesht.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Av. A. Llangozi:** Po po e kemi marrë atë po në asnjë moment nuk duket se çfarë bëjnë numëruesit në tavolinë. Nuk duket as momenti kur numërohet as çfarë kryehet. Se çfarë bëhet me fletën është tjetër gjë pastaj. Sepse mund të bëhen veprime për pavlefshmëri fletash, mund të shënohet çfarë të donin, 360 gradë do të thotë që monitorimi do të jetë i plotë dhe i gjithë anshëm. Të paktën minimalisht...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem avokat! Kamera e tavolinës se numërimit, ka qenë funksionale?

**Av. A. Llangozi:** Kamera e fletës së votimit vetëm, po ka qenë funksionale.

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë, ju keni mundësinë aposteriori të numëroni çdo votë që ka kaluar nga ajo tavolinë apo jo?

**Av. A. Llangozi:** Po, por se si ka ardhur ajo votë aty edhe nëse është apo jo...

**Z. I. Rusmali:** E rëndësishme është që çdo votë ka kaluar nga kjo kamera.

**Av. A. Llangozi:** Po kalon po nuk mundet të vërtetojmë se çfarë votash janë futur aty.

**Z. I. Rusmali:** Këtë e kuptojmë. Por e rëndësishme është që çdo votë, nuk është se ndonjë kamera nuk ka funksionuar tavoline?

**Av. A. Llangozi:** Tavoline jo, kanë funksionuar.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Kanë funksionuar dakord.

**Z. L. Braho:** Atëherë, në qoftë se ju keni pasur akses tek të gjitha kamerat për çdo QV që është numëruar. Tani ju ngrini këtë pretendimin e këtyre 18 kutive të fundit. Që tek këto 18 kuti gjithmonë sipas jush mund të jetë ndërhyrë gjatë këtij harkut kohor. Kur keni kqyrur të gjitha kamerat për çdo fletë votimi ju ka rezultuar që ka pasur fletë që nuk plotësonin kushtet, për shëmbull nuk përputhej numri i QV me kutinë e QV? Nuk ishin dy vula? Pra keni pasur ndonjë pretendim për këto 18 QV le të themi?

**Av. A. Llangozi:** Ne e kemi ngritur edhe përpara jush, që na rezulton se rreth 3 mijë vota janë me bojë dhe nuk janë të kuptueshme, e kemi ngritur përpara edhe në ankim, është pjesë e ankimit. Kështu që për këtë arsye ne do ti kërkojmë për disa rrethana kjo është një që kemi....

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Braho:** Çdo të thotë 3000 vota me bojë, edhe këto 3000 vota i përkasin këtyre 18 qendrave të votimit?

**Z. A. Llangozi:** Jo, jo vetëm këto 18, nuk bëhet fjalë për 18 qendra votimi, ne nuk po kërkojmë hapjen e 18 qendrave të votimit, po ne kërkojmë hapjen e të gjitha kutive dhe numërimin e votave dhe konstatimin dhe vlersimin. E kemi ngritur këtë problematik edhe në ankim edhe ne na ka rezultuar që rreth 3000 vota të mos plotësojnë kushtet për të qënë të vlefshme, është pjesë e ankimit tonë.

**Z. L. Maliqi:** Se nga vëzhguesit tanë pothuajse tek tavolina 5, tek tavolinat e tjera që nuk kemi patur ne numërues ka patur gjithmon tension dhe mosrakordim të shifrave, pra ne numëronim aty vëzhguesit 174 për shëmbull kandidati, rakordimi bëhej 164, ose një rast tjetër 17 fletë të pavlefshme, raportoheshin 14 të pavlefshme, kështu që këto janë të gjitha. Prandaj kërkojmë që ky proces pothuajse edhe në qendrat e votimit dhe në numërim është bërë “mal” po themi në gjuhën figurative.

**Z. A. Llangozi:** Rinumërimin e votave e kërkojmë për arsye se dera ku ishte dollapi i rëndë nuk ka patur mbulim, kuti ka patur, nuk kemi siguri në këtë pjesë dhe ne rrjedhimisht kërkojmë numërimin e këtyre votave, e para pamjet filmike nuk kanë funksionuar në këtë pjesë dhe kutitë e votimit nuk kanë qenë nën vëzhgim, kemi venA janë futur persona të cilët janë marrë me kutitë që pranojnë dhe vetë kryetari dhe këto janë rrethana të cilat ne, na bëjnë të dyshojmë për të gjithë kutitë e votimit që mund të kemi, mosrakordim mund të kemi fotokopje edhe pavlefshmëri të cilat ne i kemi ngritur në këtë proces, këto janë ato që ne kërkojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Maliqi:** Në 12:19 deri në 12:20 nuk ka patur rregullim kutish, sepse këta me gjithë stafin e dinin shumë mirë që Komuna Lumas ishte e para, pastaj vinte Kozarja, Perondia dhe Qyteti ishin të rregulluara, kur ka vajtur 12:40 filloi procesi i rregullt, s'kam bërë, - tha, asnjë lëvizje kutish.

**Z. E. Çefa:** Unë kam një pyetje të lumtem për ankimuesin. Avokat ju pretendoni që ka rreth 3000 vota, që ju thoni i plotësojnë kushtet për të qënë të pavlefshme apo jo?

**Z. A. Llangozi:** Po, 3000 vota!

**Z. E. Çefa:** Tani 3000 vota, 3000 vota është numër i konsiderueshëm nuk e di nga pamjet filmike që ju keni administruar dhe që ju i keni parë. A mund të na ilustroni qoftë edhe 50 raste të këtyre votave, të këtij grupi prej 3000 votash, që ne të indetifikojmë llojnin e parregullsisë që i bëjnë këto vota të pavlefshme në mënyrë që të gjykojmë pastaj edhe për pjesën tjetër.

**Z. A. Llangozi:** Ne, këtë ju kërkojmë kohë për ta bërë e para dhe e dyta është që ne, duhet që edhe votat t'i shikojmë fizikisht sepse na rezulton që procesverbalet kanë ikur diku, të mbylljes së qendrave të votimit i ka parë zotëria, që nuk është i besueshëm. Bëhet fjalë që mund të ketë fotokopje mund të ketë shumë dyshime të tjera të cilat ne duhet t'i shikojmë. Këto kanë qenë pjesë të ankimit tonë, përveç faktit që ne do t'i ilustrojmë edhe me video mund tju sjellim pamje filmike të këtyre votave.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Çefa:** Pikërisht pra, këtë kërkova sepse ju thatë ka... votat janë të pavlefshme për shkak të bojës, pra janë vota me bojë që unë nuk e kuptova realisht, ekzaktësisht se ku qendron po themi parregullsia e tyre, po ndoshta mendoj unë një ilustrim video të disa nga këto vota mund të na sqaronte edhe ne për atë çfarë po kërkojmë.

**Z. A. Llangozi:** Po, po do të më duhet kohë!

**Z. E. Çefa:** Po ju i keni parë videot, më keni thënë që i keni parë të gjitha videot. Apo jo?

**Z. A. Llangozi:** Po! Nëse ka ndonjëri kohë fizike t'i shohi për një kohë kaq të shkurtër, kaq orë të tëra pamjet filmike.

**Z. E. Çefa:** Pra ju po thoni që ende nuk keni indentifikuar raste të këtyre 3000 votave nga pamjet, videot që keni parë deri tani?

**Z. A. Llangozi:** Ne, kemi parë raste edhe tek videot që kemi kqyrur tek qendrat e votimit, i është hedhur bojë dhe si është hedhur ujë, fletët e votimit kanë qenë me bojë të "gallavitura" edhe nuk dukesh.

**Z. E. Çefa:** A mund të na i ilustroni pra? Ja, këtë po kërkoj. Meqë ju thoni janë 3000, ne po themi 10 na nxirrni t'i shohim.

**Z. A. Llangozi:** Po, po më duhet kohë se janë orë të tëra nuk mund të shkoi fix tek ora.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. L. Maliqi:** Në qytet unë isha aty, menjëfjalë ishin fletë votimi me bojë të rreshkitshme dhe KZAZ-ja mori vendim që këto të quhen të vazhdojnë rradhë, fletë votimi me vulë me bojë me një fjalë.


**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Një ndërhyrje të lutem, e vërteta është e tillë që në disa qendra votimi boja e vulës kishte përfunduar edhe disa anëtar aty kanë përdorur ujë në fakt, tek vula edhe për shkak të këtij shkak mund të jetë përhapur pak bojë, por ishte shumë irilevante dhe nuk ndikonte fare as në vlefshmërinë e votës, pra kuptohet që një lloj shpërndarje e çregullt, që është për shkak se është përdorur ujë, nga momenti që ne morëm djeni si KZAZ, ne jua zëvendësuam atyre në fakt, ja zëvendësuam bojën e vulës, hoqëm bojën që ishte përdorur ujë, që kishin holluar. Kishin holluar bojën e vulës me ujë për shkak se i kishte mbaruar boja nuk po funksiononte dhe gjithsesi pati kontestime nga vëzhguesit dhe në momentin e numërimit ne e vlersuam. Vlersimi jonë që normalisht fletët e votimit ishin të rregullta, i kishin të dyja fletët përkatëse i kishin formën ngjyrën edhe të gjitha elementët për vlefshmërinë e tyre dhe nuk kishte asnjë element që të çonte në pavlefshmëri.

**Z. I. Rusmali:** Këtë vlersim që ka bërë KZAZ-ja ka patur kontestime?

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Jo nuk pati kontestime.

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë është mbyllur gjithçka në momentin që ju keni vendosur që fletët janë të vlefshme.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. E. Shushari, kryetari i KZAZ-së:** Po nuk pati kontestime as nga anëtarët e grupit të numërimit përfaqësues të Koalicionit Bashkë Fitojmë, në të gjitha procesverbalet e grupit të numërimit.

**Z. K. Bele:** Mirë, mendoj që e ezauruam edhe këtë pjesë dhe këtë moment, nëse nuk kemi pyetje të tjera lidhur me pjesën e filmimeve që ne pamë, kemi për të vazhduar me kërkimet e tjera që ju keni bërë, përfaqësuesi.... unë po të pyes në procedurë pavarësisht se ke mbajtur një qëndrim po edhe unë do të shprehem në fund po është e drejta jote, po përfaqësuesi...

**Z. M. Legisi:** Për sa u diskutua! Për sa u diskutua në lidhje me fletët e votimit të pavlefshme për shkak të bojës edhe në tërësi tani në lidhje me vlerën e numërimit të votave besoj se ka transparencë të mjaftueshme, pra kamera është 360 gradë, nuk ka patur asnjë llojë indicie për cënimin e integritetit të komplet qëndres ku janë numëruar votimet, vetë pala ka patur një numër vëzhguesish të... tepër të mjaftueshëm edhe nuk ka sjellë asnjë lloj incidenti në lidhje me këtë pjesë edhe në këtë kuptim duke përfshirë edhe sqarimet e kryetarit të KZAZ-së, të gjitha këto pretendime në lidhje me sigurinë e asaj dhome mbeten deklarative edhe formale. Në këtë kuptim ne e vlersojmë që pretendimi nuk mund të jetë i pranushëm, për sa i përket votave, rreth 3000 votave të cilat kundërshtohen si të pavlefshme, po si të bëra me bojë, pala sigurisht është pala ankimuese edhe ka patur të gjitha mundësit të sjellë gjitha mundësit që të sjellë disa foto të fletëve të votimit siç është edhe procedura në raste të ngjashme në këtë Komision dhe po ashtu e pranoi që kamerat e tavolinës kanë qenë të rregullta dhe i ka kqyrur, gjithashtu në lidhje me këtë rast dha shpjegimet e tij dhe kryetari që duhet ta falenderojmë për

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

pjesmarrjen e tij në këtë proces dhe e vlersojmë që edhe për këtë rast pretendimet janë të papranueshme edhe thjeshtë deklarative, faleminderit.

**Z. K. Bele:** Faleminderit, tani duke qënë se ne kemi shqyrtuar në debat edhe kemi bërë një hetim të precedent në thojza, në raport me thellësinë ndoshta na lejoi edhe fakti që kishit vetëm këtë çështje në raport me të tjerat pavarsisht se jemi tej afateve tona proceduriale, por ne bëmë më të mirën me kqyrjen e këtj procesi i cili na vlen edhe ne për të kuptuar për detaje të mënyrës si funksionon deri në qelizë. Ndërkaq ne kemi disa kërkime tuaja në fazën e parë të cilat kanë të bëjnë me marrjen e provave të tjera, ka qënë në kërkimet tuaja paraprake do të duhet të marr dokumentin, është kryesor ku ju i keni kërkuar ato, pra ju keni kërkuar thirrjen si dëshmitar të dy përfaqësuesve, të dy shtetasve një është përfaqësuesi i subjektit politik, kandidati Kreshnik Hajdari dhe një biznesmeni Pëllumb Salillari, nuk e di në këtë fazë të procesit i qendroni mbas kësaj ecurie këtij kërkimi.

**Z. A. Llangozi:** Nëse do të merren ato prova që ne kemi paraqitur si të mirqëna...

**Z. K. Bele:** Sjellim në vëmendje edhe hetimin që është bërë nga momenti i parë deri tani, pra nëse mendoni bëjeni si...

**Z. A. Llangozi:** Ne e kemi bërë kërkesën është e drejta jonë që ne të provojmë ose detyrë e jona që ne të provojmë atë ankim që ne kemi ngritur, ne kemi pretenduar që kandidati i Partisë Socialiste Kreshnik Hajdari është ndihmuar në mënyrë të kundraligjshme dhe ky shtetas ka përfituar të ardhura në fushatë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor nga biznesmeni Pëllumb Slillari dhe në mëndojmë që është e

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

nevojshme thirrja, mund të vlersohet nga ju në çfardo vendimarrje që ju do ta mendoni por ne, i qëndrojmë kërkesës.

**Z. K. Bele:** Gjithashtu ju keni bërë një kërkesë për marrjen e të dhënave nga sistemi Teams për një shtetas. Mendoni që kjo kërkesë është gjithashtu relevante.

**Z. A. Llangozi:** Ky është një pretendim që ne e kemi ngritur sepse jemi të bindur edhe bindja më e madhe krijohet nga mosfunksionimi i pamjeve filmike në qendrën e votimit për të cilën ne kemi kërkuar thirrjen e këtij personi, na rezulton se edhe procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit në atë vend është i fallcifikuar edhe ne kemi sjellë edhe aktin e ekspertimit përkatës të cilin e kemi sjellë në cilësinë e provës rezulton se edhe 50 veta kanë votuar duke qënë jashtë shtetit, u ngrit edhe pretendimi që doja ta kundërshtoja edhe më parë nga përfaqësuesi i pozitës, Partia Socialiste, që mundet të ketë ardhur një person të ketë kaluar lufirin dhe ka votuar dhe vota duhet të quhet e vlefshme, ky është një hamendësim sepse prova shkencore Teams të cilën ne nuk e kemi marrë dot, duhet të provojë atë pretendim që ne kemi ngritur, ne në kuadër të, të dhënave personale nuk kemi patur akses dhe nuk kemi marrë dot përgjigje, jo vetëm për këtë shtetas por ne në atë qendër votimi mendojmë edhe e kemi bindjen me provat e paraqitur përpara jush se nuk ka funksionuar fare kjo qendër votimi dhe përderisa ka firmosur i njëjti person në gjith procesverbalin e qendrës së votimit mendojmë se gjithë kjo qendër është e manipuluar, e kemi provën që kemi vënë akt ekspertimi përkatës dhe ne për këtë kërkojmë jo vetëm hapjen e kësaj kutie, ne kërkojmë hapjen e të gjitha kutive por specifikisht kjo kuti rezulton që të jetë e manipuluar 100% , shtetasi ne e kemi marrë në mënyrë operative informacioni që ky shtetas ka votuar dhe ndodhet në Republikën Greke, ka ardhur vetëm 4 ditë mbas datës 14 dhe

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

nuk e dimë për çfarë arsyesh, por para kësaj date është larguar në datën 27.02.2023 drejt shtetit Grek dhe nuk ka qenë në momentin e votimit në Republikën e Shqipërisë, për këtë arsye dhe informacionet e tjera të marra në mënyrë verbale na është rezulton se kjo qendër votimi është e manipuluar dhe rreth 50 veta kanë votuar duke mos qenë në Shqipëri.

**Z. M. Legisi:** Në lidhje me kërkesën për të sjellë si deshmitar kandidatin zotin Hajdari dhe zonjën Salillari, ne konstatuam edhe nga qendrimet që mbajti avokati i ankuesit se nëpërmjet dëshmimeve të tyre kërkon të provohen fakte të cilat, vërtetësia e të cilave nëse do t'i konsiderojmë si të tilla nuk ndikojnë aspak në plotësimin e kërkesës sipas ankimit, pra në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, pavlefshmëria e zgjedhjeve është e përcaktuar në nenin 160 të Kodit Zgjedhor dhe kërkon shkeljet që kanë ndodhur në qendrën e votimit, shkeljet që kanë ndodhur në qendrën e votimit janë faktueshme mjaft mirë le të themi nga këta dhe nga procesverbalet apo materialet e tjera zgjedhore, përfshirja e personave të tjerë në vete dhe në kohë të ndryshme nuk ndikojnë aspak në lidhje me plotësueshmërisë së kësaj kërkesë, po ashu jemi për rrëzimin e kësaj kërkesë nuk mund të tejzgjatet ky proces me vërtetimin e fakteve që nuk lidhen me procesin zgjedhor, për sa i përket sigurisht verifikimit të sistemit Teams, sistemi Teams e themi edhe njëherë vërteton nëse një person ka hyrë në Shqipëri dhe jo nëse ka hyrë apo jo në qendrën e votimit, pra në këtë kuptim ne vlersojmë që nuk është një fakt i cili do të ndikojë në plotësueshmërinë e kërkesës.

**Z. K. Bele:** Kam edhe unë një pyetje. Avokat, duke qenë se ju në këtë kërkim midis të tjerash keni sjellë si dokumentacion mbështetës aktin e ekspertimit numër 48, datë 21.05.2023, nga leximi i këtij akti, në kuptueshmërinë time ju keni marrë

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

disa procesverbale të mbylljes së qendrës së votimit dhe ju mund të më korrigjoni nëse unë e kam kuptuar gabim po objekti ekspertimit ka provuar që tek rubrika e mbushjes së procesverbalit pra emrat janë shënuar në një dorë. Ju mendoni që mbushja e procesverbalit me emra nga një dorë është shkelje ligji? Apo çfarë do të provoni me këtë? Tipikisht në veprimtarinë administrative procesverbalin e mbush një person dhe mund të jetë dhe një antar dhe të tjerët firmosin. Nuk e di kush është qëllimi i këtij akti.

**Z. A. Llangozi:** Atëherë, si në Kodin e procedurës Penale , ashtu edhe për ligjin për kundravajtje administrative e kemi të përcaktuar qartë mënyrën e nënshkrimit dhe konstatimit të 1 kundravajtjeje apo qofë edhe mbajtjes së një dokumenti, nëse i referohemi të dy këtyre ligjeve na rezulton se nënshkrimi është emër, mbiemër, firmë dhe firma është si glimë, nuk është ajo që duhet të indentifikojë se kush ka firmosur ato janë edhe të paindentifikueshme ne mund t'i kontrollojmë janë të paindentifikueshme dhe nuk e di këtu nëse i referohemi Kodit Penal, edhe rasteve që kanë të bëjnë me falsifikimin e dokumentave, një person duhet të shkruaj disa herë modele të lira shkrim, nënshkrim dhe siglim sepse jo në shumë raste siglimi sjell fallsifikim. Ajo mund të jetë kushdo, nuk indentifikohen por nënshkrimi është i përcaktuar qartë që është emër, mbiemër, firmë. Emer, mbiemër, firmë janë firmosur nga persona të tjerë.

**Z. K. Bele:** Firmosja në këtë mënyrë, ka sipas jush është e parregullt në kuptim të mbushjes së këtij procesverbali.

**Z. A. Llangozi:** Po, patjetër.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. I. Rusmali:** Ju thoni në këtë qendër votimi 50 shtetas nuk kanë qenë prezent por rezultojnë votues. Emrat e këtyre 50 shtetasve i keniju?

**Z. A. Llangozi:** Kërkesë që ne, jemi drejtuar KQZ-së e kemi kërkesën të depozituar në cilësinë e provës, KQZ-ja nuk na ka dhënë informacion për arsye se këto të dhëna ndodhen në kutinë e votimit.

**Z. I. Rusmali:** Pyetja që kam unë, ju thoni 50 shtetas që skanë qenë efektivisht në Shqipëri rezultojnë votues, unë pyes! Emrat e këtyre 50 shtetasve i keni apo jo?

**Z. A. Llangozi:** Të kam dhënë një, edhe të tjerët i sjell.

**Z. I. Rusmali:** Keni sjellë një por jo të tjerët.

**Z. A. Llangozi:** T'i sjellim edhe emrat e tjerë po, po këtë e kam verifikuar në bazë të sistemit Teams për të provuar që kam akses apo jo, nëse do të kisha do t'i kisha marrë edhe informacionet e tjera.

**Z. L. Maliqi:** Të jap një përgjigje, pra kjo qendër votimi është e ish njësisë administrative të Lumas, ku në të gjithë qendrat e votimit unë kam dal fitues tek kjo qendër e votimit që është qendra më e vogël përqindja është më e madhe e pjesëmarrësve, ne pamë edhe nga kamerat se çfarë bëheshe atje dhe indicien e parë për këtë person ne e morëm nga njerëz aty brenda të zonës së fshatit, i cili tha që njihet personi aty që ka firmosur dhe për të tjerët në komision, 3417 me sa di unë dhe dua tju them që sapo të bëhet publike emri i këtij se ne e bëmë publike emrin e tij, ky person ka ardhur mbas 4 ditësh, mbase këta e kanë njoftuar që të vijë, që të

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

duket që ka kaluar kufirin, pa kaluar në sistemin Teams është punë e tyre, po që në bazë të kësaj indicie ne jemi edhe për 50 të tjerë sepse janë në procesverbal këta, përveç atyre që kanë kaluar në territor.

**Z. I. Rusmali:** Më falni që ju ndërpres, ju keni parë, keni administruar regjistrimet video të qendrës së votimit. Ju, ju rezulton që në këtë qendër votimi ky personi nuk është paraqitur? Ky, rezulton nuk është paraqitur në qendrën e votimit, në video ju nuk e shihni ndërkohë që ju rezulton votues. Si ju rezulton votues?

**Z. L. Maliqi:** Pra, sipas të dhënave që ne kemi ka dërguar kartën e identitetit dhe ka votuar.

**Z. I. Rusmali:** Nuk më duhet legjenda me duhet... Si ju rezulton votues? Ju rezulton votues se ju figuron nënshkrues në librin, në listën e zgjedhësve. Kush jua konfirmon faktin që ky është nënshkrues. Për këtë se 50 të tjerët nuk i kemi.


**Z. L. Maliqi:** Po, për këtë ne jua dhamë informacionin menjëherë që atë ditë, vëzhguesi jonë na njofton që këtu po bëhet “batërdia”....

**Z. I. Rusmali:** Mos na çohet tek batërdia, na çohet vetëm tek ky njëri. Për këtë njëri vëzhguesi ju thotë... Për këtë ka votuar dikush tjetër, që ka hedhur firmën?

**Z. L. Maliqi:** Është lehtësisht e verifikueshme dhe nga kamerat që ne pamë, po është lehtësisht e verifikueshme edhe çfarë ka ndodhur aty.

**Z. I. Rusmali:** Ju keni një foto të këtij personi?

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Foto nuk kam por më thanë që kur u bë zhurmë e madhe, mbas 4 ditëve ky person ka ardhur.

**Z. I. Rusmali:** Atëherë, nëse ne futemi dhe shikojmë të gjithë videon 12 orëshe të kësaj qendre votimi për të kërkuar këtë person. Si mund ta kërkojmë ne, këtë pa patur foto të tij?

**Z. A. Llangozi:** Tani parregullsitë në këtë qendër kanë qenë, vetëm ky person këtë po ju shpjegoi, pajisja PEI nuk ka funksionuar dhe është votuar me dorë, që ne krijojmë dyshimin e parë, e dyta është që në pamjet filmike nuk dukej fare asnjë lloj gjëje.

**Z. I. Rusmali:** Kjo është e rëndësishme që do të thotë nëse ne, kërkojmë pamjet filmike sado të përpiqemi nuk e gjejmë dot.

**Z. A. Llangozi:** Nuk e gjejmë se unë e kam kqyrur videon e parë dhe nuk duket asgjë edhe është flu.

**Z. I. Rusmali:** Ndonjë të dhënë për këtë person, që ka lidhje me indetitetin e tij, për shëmbull të dhënat, kartën e indetitetit të tij, firmën e tij në kartën e indetitetit ose ndonjë gjë të ngjashme që mund ta përdorim. Kemi apo jo? Na e vini dot në dispozicion që ne të futemi dhe të hetojmë për këtë? Sepse karta e indetitetit ka edhe firmën apo jo dhe ne mund të përpiqemi që nëpërmjet këtyre të indetifikojmë, rezulton votues apo nuk rezulton votues, nëse nuk kemi rezultat krahasues çfarë do të bëjmë ne.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Të dhënat personale ne i kemi vënë në dispozicion nëpërmjet kërkesës ndërsa shkrim edhe nënshkrim nuk i kemi.


**Z. I. Rusmali:** Pra ju thoni që mjaftojnë vetëm të dhënat personale.

**Z. K. Bele:** Në fund të këtij diskutimi ju lutem t'i qëndroni kërkesës suaj për këtë pjesë të kërkimit, pra për marrjen e këtij informacioni.

**Z. A. Llangozi:** Po, patjetër!

**Z. K. Bele:** Vijnë tek kërkesa juaj e tretë, që ju kërkonti gjithashtu marrjen e provave nga hapja e kutive të votimit numërim, rinumërim dhe pyetja që lind në këtë rast... I keni të indentifikuara kutitë që ju kërkonti? Pasi që duhet tju kujtojmë që për të arritur tek një kërkesë e tillë duhet sipas një rregullimi ligjor dhe një praktike dhe të mëparëshme dhe të mirëstabilizuar, kërkohet nisur nga indiciet konkrete mbi një qendër votimi, pra ta shpjeguar se këtë procedurë ne, e kemi bërë disa herë gjatë këtyre zgjedhjeve por edhe më parë në zgjedhje të tjera dhe ata që kanë qenë përpara nesh në këtë... formë tjetër por në të njëjtën tavolinë. Si funksionon? Pra për një qendër të caktuar votimi pretendohet që ka 1, 2, 3, 4 dhe 5 shkelje, që ka edhe mospërputhje mbi të cilat kërkohet gjetja e provueshmërisë së këtyre shkeljeve nëpërmjet hapjes së qendrës së votimit, që mund të jenë vota të pavlefshme të bëra të vlefshme apo anasjelltas, vota të numëruara gabim apo kërkime specifike për një qendër votimi dhe mbi atë pretendim pastaj mund të shkohet rast pas rasti tek hapja e kutisë.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

**Z. A. Llangozi:** Një rast është aktual, që ne e paraqitëm por unë jo pa qëllim kam kërkuar edhe materialin tjetër zgjedhor të cilin nuk më është vënë në dispozicion, dua t'i shoh të gjitha këto materiale që kanë ardhur ditën e sotme, i kam kërkuar edhe më parë nuk më janë vënë në dispozicion me arsyetimin që ishin në kuti, ndërkohë nuk ndodhen në kuti ndodhen pranë jush tani, kanë qënë tek shtëpia e zotit Shushari të cilën ne kërkojmë një kopie dhe do të rakordojmë pastaj.

**Z. K. Bele:** Këto janë kopje që u kërkuan nga ana jonë për të provuar atë pretendim që ngritët ju dhe lidheshin vetëm me një qendër votimi për të hetuar ekzistencën.

**Z. A. Llangozi:** Nuk lidhet vetëm me një qendër votimi sepse në video duket vetëm një procesverbal që ka të njëjtat kode por aty janë disa procesverbale nuk është se është një.

**Z. K. Bele:** Dakord, pra ju e kërkoni marrjen e këtyre dhe vijmë tek qendrimi të cilin ju e keni artikuluar për hapjen e kutive. Keni për t'i ndenjtur të njëjtit qendrim që kërkoni hapjen e të gjithë kutive apo doni të ...

**Z. A. Llangozi:** Ne kërkojmë hapjen e të gjithë kutive sepse arsyet janë:

1-Arsyeja është fakti që kutitë nuk kanë qënë të monitoruara me pamje filmike, vërtetohet plotësisht që nuk janë të monitoruara, është krijuar dyshimi për shkak të... nga ora 11:30 deri në 12:40 që ka patur edhe hyrje jashtë vendimit përkatës nga persona të pa autorizuar dhe fakti tjetër që nuk i ka bërë të sigurt kutitë e votimit është edhe dera përkatëse që ka patur edhe atë dollapin. Kështu që këto janë arsyet për të cilat ne dyshojmë dhe fakti tjetër është që asnjë procesverbal asnjë material zgjedhor nuk ndodhet në kutitë përkatëse, ndodhen në dispozicion të

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.06.2023*

një personi. Ju vlersoj shumë për faktin që thirrët një dëshmitar që ishte zoti Shushari, pra atë pretendim që ne kemi ngritur që dhe 3000 vota janë të pavlefshme dhe zoti Shushari e pranoj që ka patur të njëjtën problematik të cilën kemi ngritur ne, ne i vlersojmë të gjitha ato vota të cilat ne i kemi kontestuar në ankim, sepse unë atë nuk e kam patur pjesë të ankimit, e kam patur pjesë të ankimit atë pjesën e bojës që është e shkruar në ankim.

**Z. K. Bele:** Atëherë duke konkluduar, ne kemi tre kërkimet tuaja të paraqitura si kërtime paraprake por edhe të përforcuara gjatë hetimit dhe sillen të rikonfirmuara me këtë kërkim tuajin, duke qënë se nuk kemi pyetje të tjera dhe duke qënë se provat e paraqitura nga ana juaj janë administruar dhe janë pjesë e fashikullit, në përfundim të marrjes së provave të shkresore audio dhe video që janë paraqitur nga ju, apo marrë edhe nga administrata me kërkesën tonë, në këtë fazë ne do të duhet tërhiqemi për t'u shprehur për këto tre kërkesa dhe ne, do të marrim një kohë ndoshta 10-5 minuta, shpresojmë jo më shumë, sepse duam të jemi rracional për tu shprehur për këto tre kërkesa.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida KOCAQI*

